



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 12

Tiranë – E enjte, 18 janar 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 204, datë 28.12.2023	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 16, datë 19.10.2022, “Për rregullat për masat e veçanta të kontrollit për të parandaluar hyrjen dhe përhapjen brenda vendit të Xylella Fastidiosa (Wells Et Al)” 2129
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 8, datë 9.1.2024	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së murtajes afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut..... 2133
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 218, datë 29.12.2023	Për miratimin e rregullores për përcaktimin e rregullave të detajuara në lidhje me pranimin e certifikatave të pilotëve nga vendet e tjera 2136
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 67, datë 6.12.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 9577, datë 6.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 433, datë 16.10.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë; nr. 00-2016-2892, datë 11.11.2016, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 163, datë 29.6.2017, të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë..... 2143
Vendim i Komsionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 6, datë 12.1.2024	Për shpalljen e moszgjedhshmërisë së kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, qarku Tiranë, znj. Dallëndyshe Agim Bici, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë..... 2155
Vendim i Komsionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 7, datë 15.1.2024	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumëmemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, qarku Tiranë, z. Plarent Pjetër Ndreca..... 2156
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 9, datë 23.1.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 2158
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 10, datë 23.1.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike..... 2159

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 14, datë 27.1.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Tplani Hc” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw.....	2160
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 15, datë 27.1.2023	Mbi kërkesën e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2162
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 135, datë 11.4.2023	Mbi miratimin e amendimit nr. 2 të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a dhe KESH sh.a”.....	2163
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 138, datë 14.4.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2164
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 139, datë 14.4.2023	Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë.....	2165
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 222, datë 10.7.2023	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin qershor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kv.....	2166
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 223, datë 10.7.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.....	2168
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 224, datë 10.7.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Lajthiza Invest’ sh.a në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw”, i ndryshuar	2169
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 229, datë 19.7.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Sun Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 2 mw.....	2170
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 230, datë 19.7.2023	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet të instaluar 20 mw (AC).....	2171
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 231, datë 19.7.2023	Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Eu Green Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2172
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 232, datë 19.7.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Spv Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2173
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 233, datë 19.7.2023	Mbi licencimin e shoqërisë “Spv Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike	2174

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 234, datë 19.7.2023	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2175
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 235, datë 19.7.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 243, datë 2.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”.....	2176
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 355, datë 1.12.2023	Mbi fillimin e procedurës për kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..	2177
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 356, datë 1.12.2023	Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 126, datë 31.5.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Energy Financing Team T’irana’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”	2178
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 358, datë 1.12.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	2179
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 359, datë 1.12.2023	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	2180
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur dhe të vdekur të shtetasit Vasillaq Vidhaj	2181



UDHËZIM

Nr. 204, datë 28.12.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË
UDHËZIMIN NR. 16, DATË 19.10.2022,
“PËR RREGULLAT PËR MASAT E
VEÇANTA TË KONTROLLIT PËR TË
PARANDALUAR HYRJEN DHE
PËRHAPJEN BRENDË VENDIT TË
XYLELLA FASTIDIOSA (WELLS ET AL)”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në pikën 3, të nenit 8, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 16, datë 19.10.2022, bëhen këto ndryshime:

1. Anekset I dhe II, i udhëzimit nr. 16, datë 19.10.2022, zëvendësohen me anekset I dhe II, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL

Anila Denaj

ANEKS I

**LISTA E BIMËVE QË DIHET SE JANË TË
NDJESHME NDAJ NJË OSE MË SHUMË
NËNSPECIEVE TË DËMTUESIT TË
SPECIFIKUAR (“BIMËT BUJTËSE”)**

Acacia Mill.

Acer L.

Adenocarpus lainzii (Castrov.) Castrov.

Albizia julibrissin Durazz.

Alnus rhombifolia Nutt.

Amaranthus retroflexus L.

Ambrosia L.

Ampelopsis arborea (L.) Koehne

Ampelopsis brevipedunculata (Maxim.) Trautv.

Ampelopsis cordata Michx.

Anthyllis barba-jovis L.

Anthyllis hermanniae L.

Arbutus unedo L.

Argyranthemum frutescens (L.) Sch.Bip.

Artemisia L.

Asparagus acutifolius L.

Athyrium filix-femina (L.) Roth

Baccharis L.

Berberis thunbergii DC.

Brassica L.

Calicotome spinosa (L.) Link

Calicotome villosa (Poir.) Link

Callicarpa americana L.

Callistemon citrinus (Curtis) Skeels

Calluna vulgaris (L.) Hull

Calocephalus brownii (Cass.) F.Muell.

Carya Nutt.

Catharanthus roseus (L.) G.Don

Celtis occidentalis L.

Cercis canadensis L.

Cercis occidentalis Torr.

Cercis siliquastrum L.

Chamaecrista fasciculata (Michx.) Greene

Chenopodium album L.

Chionanthus L.

x Chitalpa tashkentensis T. S. Elias & Wisura

Cistus L.

Citrus L.

Clematis cirrhosa L.

Clematis vitalba L.

Coelorachis cylindrica (Michx.) Nash

Coffea L.

Conium maculatum L.

Convolvulus cneorum L.

Coprosma repens A.Rich.

Coronilla L.

Cortaderia selloana (Schult. & Schult.f.) Asch. & Graebn.

Cyperus eragrostis Lam.

Cytisus Desf.

Digitaria Haller

Dimorphotheca ecklonis (DC.) Norl.

Dimorphotheca fruticosa (L.) Norl.

Diospyros kaki L.f.

Diplocyclos palmatus (L.) C.Jeffrey

Dittrichia viscosa (L.) Greuter

Dodonaea viscosa (L.) Jacq.



- Echium plantagineum* L.
Elaeagnus angustifolia L.
Elaeagnus × *submacrophylla* Servett.
Encelia farinosa A.Gray ex Torr.
Eremophila maculata (Ker Gawler) F. von Müller.
Erica cinerea L.
Erigeron L.
Eriocephalus africanus L.
Erodium moschatum (L.) L'Hérit.
Erysimum L.
Euphorbia chamaesyce L.
Euphorbia terracina L.
Euryops chrysanthemoides (DC.) B.Nord.
Euryops pectinatus (L.) Cass.
Fagus crenata Blume
Fallopia japonica (Houtt.) Ronse Decr.
Fatsia japonica (Thunb.) Decne. & Planch.
Ficus carica L.
Frangula alnus Mill.
Fraxinus L.
Gazania rigens (L.) Gaertn.
Genista L.
Ginkgo biloba L.
Gleditsia triacanthos L.
Grevillea juniperina Br.
Hebe Comm. ex Juss.
Helianthus L.
Helicbrysum Mill.
Heliotropium europaeum L.
Hemerocallis L.
Hevea brasiliensis (Willd. ex A.Juss.) Müll.Arg.
Hibiscus L.
Humulus scandens (Lour.) Merr.
Hypericum androsaemum L.
Hypericum perforatum L.
Ilex aquifolium L.
Ilex vomitoria Sol. ex Aiton
Iva annua L.
Jacaranda mimosifolia D. Don
Jacobaea maritima (L.) Pels & Meijden
Juglans L.
Juniperus ashei J. Buchholz
Koelreuteria bipinnata Franch.
Lagerstroemia L.
Laurus nobilis L.
Lavandula L.
Lavatera cretica L.
Ligustrum lucidum W.T.Aiton.
Liquidambar styraciflua L.
Lonicera implexa Soland.
Lonicera japonica Thunb.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Lupinus villosus Willd.
Magnolia grandiflora L.
Magnolia × *soulangeana* Soul.-Bod.
Mallotus paniculatus (Lam.) Müll.Arg.
Medicago arborea L.
Medicago sativa L.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Mimosa L.
Modiola caroliniana (L.) G. Don
Morus L.
Myoporum insulare R.Br.
Myoporum laetum G. Forst.
Myrtus communis L.
Nandina domestica Murray
Neptunia lutea (Leavenw.) Benth.
Nerium oleander L.
Olea L.
Parthenocissus quinquefolia (L.) Planch.
Paspalum dilatatum Poir.
Pelargonium L'Hér. ex Aiton
Perovskia abrotanoides Kar.
Persea americana Mill.
Phagnalon saxatile (L.) Cass.
Phillyrea angustifolia L.
Phillyrea latifolia L.
Phlomis fruticosa L.
Phlomis italica L.
Phoenix reclinata Jacquin
Phoenix roebelenii O'Brien
Pinus taeda L.
Pistacia vera L.
Plantago lanceolata L.
Platanus L.
Pluchea odorata (L.) Cass.
Polygala grandiflora Wight
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Psidium L.
Pteridium aquilinum (L.) Kuhn
Pyrus L.
Quercus L.
Ratibida columnifera (Nutt.) Wooton & Standl.
Retama monosperma (L.) Boiss.
Rhamnus L.
Rhus L.
Robinia pseudoacacia L.
Rosa L.
Rubus L.



Ruta chalepensis L.
Ruta graveolens L.
Salvia apiana Jeps.
Salvia mellifera Greene
Salvia officinalis L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Santolina chamaecyparissus L.
Santolina magonica (O.Bolòs, Molin. & P.Monts.)

Romo

Sapindus saponaria L.
Sassafras L. ex Nees
Scabiosa atropurpurea var. *maritima* L.
Setaria magna Griseb.
Solidago fistulosa Mill.
Solidago virgaurea L.
Sorghum halepense (L.) Pers.
Spartium L.
Stewartia pseudocamellia Maxim.
Strelitzia reginae Aiton
Streptocarpus Lindl.
Symphytotrichum divaricatum (Nutt.) G.L.Nesom
Syringa vulgaris L.
Teucrium capitatum L.
Thymus vulgaris L.
Trifolium repens L.
Ulex L.
Ulmus L.
Vaccinium L.
Viburnum tinus L.
Vinca L.
Vitex agnus-castus L.
Vitis L.
Westringia fruticosa (Willd.) Druce
Westringia glabra R.Br.
Xanthium strumarium L.ʹ

Citrus limon (L.) Osbeck
Citrus paradisi Macfad.
Citrus reticulata Blanco
Citrus sinensis (L.) Osbeck
Coffea L.
Elaeagnus angustifolia L.
Erysimum L.
Ficus carica L.
Genista lucida L.
Juglans regia L.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Magnolia grandiflora L.
Medicago sativa L.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Morus L.
Myrtus communis L.
Nerium oleander L.
Pelargonium graveolens L'Hér.
Pluchea odorata (L.) Cass.
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Psidium L.
Rhamnus alaternus L.
Rubus rigidus Sm.
Rubus ursinus Cham. & Schldl.
Ruta chalepensis L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Spartium junceum L.
Strelitzia reginae Aiton
Streptocarpus Lindl.
Teucrium capitatum L.
Ulex europaeus L.
Ulmus americana L.
Vaccinium corymbosum L.
Vinca L.
Vitis L.

ANEKS II

LISTA E BIMËVE QË DIHET SE JANË TË
 NDJESHME NDAJ NËNSPECIEVE
 SPECIFIKE TË DËMTUESIT TË
 SPECIFIKUAR (BIMËT TË SPECIFIKUARA)

**Bimët e specifikuara të ndjeshme ndaj
Xylella fastidiosa nënspecie *fastidiosa***

Acer L.
Ambrosia artemisiifolia L.
Calicotome spinosa (L.) Link
Cercis occidentalis Torr.
Cistus monspeliensis L.

**Bimët të specifikuara të ndjeshme ndaj
 nënspecies *Xylella fastidiosa* multiplex**

Acacia Mill.
Acer griseum (Franch.) Pax
Acer pseudoplatanus L.
Acer rubrum L.
Adenocarpus lainzii (Castrov.) Castrov.
Alnus rhombifolia Nutt.
Ambrosia L.
Ampelopsis cordata Michx.
Anthyllis barba-jovis L.
Anthyllis hermanniae L.



- Arbutus unedo* L.
Argyranthemum frutescens (L.) Sch.Bip.
Artemisia L.
Asparagus acutifolius L.
Athyrium filix-femina (L.) Roth
Baccharis halimifolia L.
Berberis thunbergii DC.
Calicotome spinosa (L.) Link
Calicotome villosa (Poir.) Link
Callistemon citrinus (Curtis) Skeels
Calluna vulgaris (L.) Hull
Calocephalus brownii (Cass.) F.Muell
Carya Nutt.
Celtis occidentalis L.
Cercis canadensis L.
Cercis occidentalis Torr.
Cercis siliquastrum L.
Chionanthus L.
Cistus L.
Clematis cirrhosa L.
Clematis vitalba L.
Convolvulus cneorum L.
Coprosma repens A.Rich.
Coronilla L.
Cytisus Desf.
Dimorphotheca ecklonis (DC.) Norl.
Dimorphotheca fruticosa (L.) Norl.
Dittrichia viscosa (L.) Greuter
Dodonaea viscosa (L.) Jacq.
Echium plantagineum L.
Elaeagnus angustifolia L.
Elaeagnus × submacrophylla Servett.
Encelia farinosa A.Gray ex Torr.
Erica cinerea L.
Erigeron L.
Eriosepalus africanus L.
Erodium moschatum (L.) L'Hérit.
Euryops chrysanthemoides (DC.) B.Nord.
Euryops pectinatus (L.) Cass.
Fallopia japonica (Houtt.) Ronse Decr.
Ficus carica L.
Frangula alnus Mill.
Fraxinus L.
Gazania rigens (L.) Gaertn.
Genista L.
Ginkgo biloba L.
Gleditsia triacanthos L.
Grevillea juniperina Br.
Hebe Comm. ex Juss.
Helianthus L.
Helichrysum Mill.
Hibiscus syriacus L.
Hypericum androsaemum L.
Hypericum perforatum L.
Ilex aquifolium L.
Iva annua L.
Jacobaea maritima (L.) Pelser & Meijden
Koeleruteria bipinnata Franch.
Lagerstroemia L.
Laurus nobilis L.
Lavandula L.
Lavatera cretica L.
Liquidambar styraciflua L.
Lonicera implexa Soland.
Lonicera japonica Thunb.
Lupinus aridorum McFarlin ex Beckner
Lupinus villosus Willd.
Magnolia grandiflora L.
Magnolia × soulangeana Soul.-Bod.
Medicago arborea L.
Medicago sativa L.
Metrosideros Banks ex Gaertn.
Myoporum laetum G.Forst.
Myrtus communis L.
Nerium oleander L.
Olea L.
Pelargonium L'Hér. ex Aiton
Perovskia abrotanoides Kar.
Phagnalon saxatile (L.) Cass.
Phillyrea angustifolia L.
Phlomis fruticosa L.
Phlomis italica L.
Pistacia vera L.
Plantago lanceolata L.
Platanus L.
Polygala grandiflora Wight
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Pteridium aquilinum (L.) Kuhn
Quercus L.
Ratibida columnifera (Nutt.) Wooton & Standl.
Retama monosperma (L.) Boiss.
Rhamnus L.
Robinia pseudoacacia L.
Rosa L.
Rubus L.
Ruta graveolens L.
Salvia apiana Jeps.
Salvia mellifera Greene
Salvia officinalis L.



Salvia rosmarinus Spenn.
Sambucus L.
Santolina chamaecyparissus L.
Santolina magonica (O.Bolòs, Molin. & P.Monts.)

Romo

Sapindus saponaria L.
Scabiosa atropurpurea var. *maritima* L.
Solidago virgaurea L.
Spartium L.
Strelitzia reginae Aiton
Syringa vulgaris L.
Ulex L.
Ulmus L.
Vaccinium L.
Viburnum tinus L.
Vinca L.
Vitex agnus-castus L.
Westringia fruticosa (Willd.) Druce
Xanthium strumarium L.

Bimët të specifikuara të ndjeshme ndaj nënspecieve *Xylella fastidiosa* pauca

Acacia Mill.
Amaranthus retroflexus L.
Asparagus acutifolius L.
Catharanthus roseus (L.) G.Don
Chenopodium album L.
Cistus albidus L.
Cistus creticus L.
Citrus L.
Coffea L.
Dimorphotheca fruticosa (L.) Norl.
Dodonaea viscosa (L.) Jacq.
Elaeagnus angustifolia L.
Eremophila maculata (Ker Gawler) F. von Müller.
Erigeron L.
Euphorbia chamaesyce L.
Euphorbia terracina L.
Genista hirsuta Vahl.
Grevillea juniperina Br.
Hebe Comm. ex Juss.
Heliotropium europaeum L.
Hibiscus L.
Laurus nobilis L.
Lavandula L.
Myoporum insulare R.Br.
Myrtus communis L.
Nerium oleander L.
Olea europaea nënsp. *europaea* L.
Olea europaea nënsp. *sylvestris* (Mill.) Rouy

Pelargonium L'Hér. ex Aiton
Phillyrea latifolia L.
Pistacia vera L.
Polygala myrtifolia L.
Prunus L.
Rhamnus alaternus L.
Salvia rosmarinus Spenn.
Spartium junceum L.
Thymus vulgaris L.
Ulex parviflorus Pourr.
Vinca minor L.
Westringia fruticosa (Willd.) Druce
Westringia glabra R.Br.?

URDHËR

Nr. 8, datë 9.1.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E MAQEDONISË SË VERIUT

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, në nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e OIE-së dhe ADIS-së, përkatësisht nga ndarjet administrative të përcaktuara në tabelën e mëposhtme.

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë*	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Češinovo-Obleševo	Ularci*	
Delcevo*		
Karbinci	Karbinci*	
Kočani*		
Kratovo*		
Gostivar*		
Gradsko*		
Kriva Palanka*		
Kumanovo	Kumanovo*	
Kumanovo	Dolno Konjare*	
Kumanovo	Ljubodrag*	



Kumanovo	Tabanovce*	
Kumanovo	Recica*	
Makedonska Kamenica	Moshtica*	
Makedonska Kamenica	Preseka*	
Makedonska Kamenica	Glavovica*	
Novo Selo	Novo Selo*	
Probištip	Drenok*	
Probištip	Shtalkovica*	
Probištip	Stalkovica*	
Rankovce*		
Staro Nagoričane	Staro Nagoričane*	
Staro Nagoričane	Arbanasko*	
Staro Nagoričane	Tromeđa*	
Štip	Štip*	
Vinitsa	Vinitsa*	
Vinitsa	Vinicka Krshla*	
Vrapčište*		
Novatsi*		
Kavadartsi*		
Pehčevo*		
Zajas*		
Makedonski Brod*		
Vraneštica*		
Čaška*		
Oslomej*		

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet*

2. Lejimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, produkteve të tyre, materialit biologjik dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit derra, mishin e freskët dhe nënprodukteve të tyre të kafshëve të llojit derra, nga ndarjet administrative të shtetit të Maqedonisë së Veriut të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, të painfektuara nga sëmundja, nëse plotësohen kushtet e mëposhtme nga pika 2.1 deri në pikën 2.8:

2.1 Për kafshët e gjalla të llojit derra të butë dhe të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët:

a) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtagjës afrikane të derrave ditën e dërgesës;

b) janë mbajtur që nga lindja ose për tre muajt e fundit në një kompartament (zonë) pa prezencë të murtagjës afrikane të derrave; ose

c) janë mbajtur në një stacion karantine, të izoluar për 30 ditë përpara dërgesës dhe i janë nënshtruar një testi virologjik dhe një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas hyrjes në stacionin e karantinës, me rezultate negative.

2.2. Për materialin biologjik të kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore

veterinare duhet të vërtetojë që kafshët donatore të materialit biologjik:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtagjës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenja klinike të murtagjës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së materialit biologjik;

c) sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve është në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 15.1.10 ose nenin 15.1.11, të Kodit Terrestrial të OIE-së sipas rastit.

2.3. Për embrionet e derivuara *in vivo* të derrave të butë, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që kafshët donatore të embrioneve:

a) janë mbajtur që nga lindja ose për të paktën tre muaj para grumbullimit të embrioneve në një stacion, në të cilin janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtagjës afrikane të derrave, nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) nuk kanë shfaqur shenjë klinike të murtagjës afrikane të derrave në ditën e mbledhjes së embrioneve;

c) i janë nënshtruar një testi serologjik të kryer të paktën 21 ditë pas grumbullimit, me rezultate negative;

ç) embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me dispozitat përkatëse të kapitujve 4.8 dhe 4.10, të Kodit Terrestrial të OIE-së.

2.4. Për mishin e kafshëve të llojit derra të butë ose të egër, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshët e llojit derra, që kanë origjinën nga tufat në



të cilat janë mbikëqyrur në përputhje me nenet 15.1.28 deri në 15.1.30 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe vërteton se asnjë rast i murtajes afrikane të derrave nuk ka ndodhur në tri vitet e fundit. Kjo periudhë reduktohet në 12 muaj, vetëm nëse survejanca demonstron dokumenton se nuk ka dëshmi të përfshirjes së rriqnave në epidemiologjinë e infeksionit;

b) janë testuar mostra nga një numër statistikisht përfaqësues i kafshëve për sëmundjen e murtajes afrikane të derrave, me rezultate negative;

c) e gjithë ngarkesa e mishit të freskët vjen nga kafshë të cilat janë therur në një thertore të miratuar dhe i janë nënshtruar kontrollit me rezultate të favorshme të inspektimit para dhe pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

ç) janë marrë masat e nevojshme pas therjes për të shmangur kontaktin e mishit të freskët me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.5. Për mishin e freskët të kafshëve të egra të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) janë vlarë në një vend ose zonë të lirë nga murtaja afrikane e derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2 të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) i janë nënshtruar me rezultate të favorshme një inspektimi pas vdekjes, në përputhje me kapitullin 6.3 të Kodit Terrestrial të OIE-së në një objekt ekzaminimi të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti.

2.6. Për produktet e mishit të kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) mishi i freskët plotëson kushtet përkatëse në nenet 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së;

b) mishi është përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti dhe ka plotësuar kushtet përkatëse të neneve 15.1.14, 15.1.15 dhe 15.1.16 të Kodit Terrestrial të OIE-së; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar, për qëllime eksporti, në mënyrë që të sigurohet shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me nenin 15.1.23 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit të mishit për të

shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.7. Për qimet (e pjesës së shpinës) e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) e kanë origjinën nga derrat e egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose ndarje pa prezencë të murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga proceset e listuara në nenin 15.1.26 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat e nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin me produktin me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

2.8. Për lëkurët e kafshëve të llojit derra, certifikata shëndetësore veterinarë duhet të vërtetojë që:

a) kanë ardhur nga derra të një vendi ose zone të lirë nga sëmundja e murtajes afrikane të derrave, në përputhje me pikën 1 ose me pikën 2, të nenit 15.1.4 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

b) origjinojnë nga derra të egër ose të butë të kapur në një vend, zonë ose kompartament pa prezencë të sëmundjes së murtajes afrikane të derrave dhe janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti; ose

c) janë përpunuar në një objekt të miratuar nga autoriteti veterinar për qëllime eksporti, ku është siguruar shkatërrimi i virusit të murtajes afrikane të derrave, në përputhje me një nga procedurat e përmendura në nenin 15.1.25 të Kodit Terrestrial të OIE-së dhe janë marrë masat paraprake të nevojshme pas përpunimit për të shmangur kontaktin e produktit me çdo burim të virusit të murtajes afrikane të derrave.

3. Urdhri nr. 756, datë 22.11.2023, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së Murtajes Afrikane të derrave të shfaqur në shtetin e Maqedonisë së Veriut”, shfuqizohet.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe



Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të llojit derra, produkteve dhe nënprodukteve të tyre, materialit biologjik, embrioneve, mishit dhe nënprodukteve të tyre.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR

Nr. 218, datë 29.12.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA NË LIDHJE ME PRANIMIN E CERTIFIKATAVE TË PILOTËVE NGA VENDET E TJERA¹

Në zbatim të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7 shkronja “ç”, nenit 27, nenit 28 dhe nenit 46, të ligjit nr. 96/2020 “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e rregullave të detajuara në lidhje me pranimin e

certifikatave të pilotëve nga vendet e treta”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

Seksioni 1

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Fusha e veprimit

Kjo rregullore përcakton rregulla të detajuara lidhur me kushtet për pranimin e licencave të pilotëve dhe kategorizimeve, privilegjeve ose certifikatave shoqëruese, si dhe certifikatave përkatëse mjekësore, të lëshuara nga vendet jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Përkufizimet

1. Përkufizimet e përfshira në urdhrin e ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullore “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil”, apo çdo përditësimi të tij, që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, në rregulloren “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e balonave”, që transponon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/395 dhe në rregulloren “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave”, që transponon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/1976, do të zbatohen për qëllimet e kësaj rregulloreje.

2. Për më tepër, për qëllimet e kësaj rregulloreje, “fluturimet e prodhuesit” nënkuptojnë fluturimet e referuara në nenin 6 (3) të urdhrin të ministrit nr. 80,

¹ Ky urdhër përafron plotësisht Rregulloren e Komisionit (BE) 2020/723, datë 4 mars 2020, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së L 170, datë 2.6.2020.

datë 30.6.2023, “Për miratimin e rregullores “Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative për operimet ajrore”, apo çdo përditësim të tij.

Neni 3

Pranimi i licencave të lëshuara për interes të vendeve jashtë Republikës së Shqipërisë

1. Autoriteti i Aviacionit Civil pranon pa vonesa të panevojshme, licencat e pilotit dhe kategorizimet, privilegjet ose certifikatat përkatëse, si dhe certifikatat shoqëruese mjekësore të lëshuara nga autoritete kompetente të vendeve të BE- së apo EASA, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”.

2. Pa cenuar marrëveshjet ndërkombëtare të lidhura midis Republikës së Shqipërisë dhe atyre vendeve që s’janë vende të BE-së ose ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, në përputhje me pikën (a) të nenit 68 (1), të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Mbi miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, Autoriteti i Aviacionit Civil mundet, që:

a) në përputhje me seksionin 2 të kësaj rregulloreje, të pranojë licencat e pilotit dhe kategorizimet, privilegjet ose certifikatat përkatëse, si dhe certifikatat shoqëruese mjekësore të lëshuara në përputhje me ligjet e atyre vendeve që s’janë vende të BE-së, ose partnere të ZPEA-së, të quajtura vende të treta;

b) në përputhje me nenin 3 të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësimi të tij, që transpozon rregulloren (BE) nr. 1178/2011 dhe çdo ndryshim të saj, nenin 3a të rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e balonave”, që transpozon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/395, ose nenin 3a të rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave”, që transpozon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/1976, sipas rastit, të lëshojë licenca ekuivalente për aplikantët që tashmë mbajnë një licencë, kategorizim, privilegj ose certifikatë ekuivalente të lëshuara në përputhje me aneksin 1 të Konventës Ndërkombëtare të

Aviacionit Civil, nënshkruar më 7 dhjetor 1944 në Çikago (‘Konventa e Çikagos’) nga ato vende që s’janë vende të BE-së ose ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, me kusht që ata aplikantë të jenë në përputhje me kërkesat e Seksionit 3 dhe duke marrë parasysh çdo kredit të bazuar në rekomandimin e një organizate të miratuar të trajnimit ose një organizate të deklaruar të trajnimit;

c) të japë kredite të plota në lidhje me kërkesat për t’iu nënshtruar një kursi trajnimi përpara ndërmarrjes së provimeve për njohuritë teorike dhe testit të aftësive për mbajtësit e licencës së pilotëve të transportit ajror (“ATPL”) të lëshuar nga ose në emër të atyre vendeve që s’janë vende të BE-së ose ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos me kusht që këta mbajtës të kenë plotësuar kërkesat e përvojës për lëshimin e një ATPL në kategorinë përkatëse të avionëve siç përcaktohet në nënpjesën F të aneksit I të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësimi të tij, që transpozon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar, dhe me kusht që licenca e lëshuar nga ato vende që s’janë vende të BE-së ose ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, të përmbajë një kategorizim të tipit të vlefshëm për avionët që do të përdoren për testin e aftësive ATPL;

d) të lëshojë kategorizimet e tipit të aeroplanit ose helikopterit për mbajtësit e licencave të lëshuara në përputhje me urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësimi të tij, që transpozon rregulloren (BE) nr. 1178/2011 dhe ndryshime të saj, që përputhen me kërkesat e përcaktuara nga ai shtet që s’është vend i BE-së ose ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, për lëshimin e kategorizimeve të tilla; këto kategorizime do të kufizohen në avionët e regjistruar në atë shtet që s’është vend i BE-së ose ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe, por ky kufizim mund të hiqet kur piloti përputhet me kërkesat e nenit 10 të kësaj rregulloreje.



Seksioni 2
Validimi i licencave

Neni 4
Dispozita të përgjithshme për validimin e licencave

1. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të validojë një licencë piloti të lëshuar nga ato vende që s'janë vende të BE-së ose ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe në përputhje me kërkesat e aneksit 1 të Konventës së Çikagos.

2. Për qëllimet e dispozitave të përcaktuara në këtë rregullore, Autoriteti i Aviacionit Civil do të jetë si vijon:

a) autoritet kompetent i shtetit ku piloti është vendosur ose banon për pilotët që banojnë brenda territorit të BE-së;

b) autoritet kompetent i Shtetit ku operatori për të cilin ata fluturojnë ose synojnë të fluturojnë, ka vendin kryesor të biznesit, ose ku avioni me të cilin ata fluturojnë ose synojnë të fluturojnë është regjistruar, për pilotët që nuk banojnë në territorin e BE-së.

3. Validimi i një licence do të ketë një periudhë vlefshmërie, e cila nuk kalon një vit dhe privilegjet e saj do të ushtrohen për sa kohë që licenca mbetet e vlefshme.

Autoriteti i Aviacionit Civil që ka validuar licencën mund të zgjasë vlefshmërinë vetëm një herë dhe vetëm me një maksimum prej një viti, nëse gjatë periudhës së vlefshmërisë piloti ka aplikuar për licencë në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores 'Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil'", apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011 dhe amendimet e saj ose është duke kaluar trajnime për lëshimin e një licence të tillë. Në rastin e fundit, zgjatja do të mbulojë periudhën kohore të nevojshme për lëshimin e licencës në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores 'Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil'", që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011.

3.a Parashikimi i pikës 3 vlen edhe për rastin kur, gjatë periudhës së vlefshmërisë piloti ka aplikuar për licencë në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të

urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores 'Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil'", apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011 dhe amendimet e saj ose është duke kaluar trajnime për lëshimin e një licence të tillë. Në rastin e fundit, zgjatja do të mbulojë periudhën kohore të nevojshme për lëshimin e licencës në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të rregullores (BE) nr. 1178/2011.

4. Mbajtësit e një licence të validuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil do të ushtrojnë privilegjet e tyre në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023 "Për miratimin e rregullores 'Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil'", apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011 dhe amendimet e saj.

Neni 5
Licencat e pilotëve të transportit ajror tregtar dhe aktivitete të tjera tregtare

Për validimin e licencave të pilotit për transport ajror tregtar dhe aktivitete të tjera tregtare, mbajtësit duhet të përputhen me kërkesat e mëposhtme, për privilegjet e kërkuara, sipas rastit:

a) të kryejnë si një test aftësie, rivleftësimin e kategorizimit të klasës ose tipit sipas kërkesave të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores 'Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil'", apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar, në lidhje me privilegjet e licencës së mbajtur;

b) të demonstrojnë njohuri për pjesët përkatëse të kërkesave operationale dhe aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, "Për miratimin e rregullores 'Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil'", apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar.

c) të demonstrojnë aftësi të gjuhës në përputhje me pikën FCL.055 të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023 "Për



miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar;

d) të kenë një certifikatë të vlefshme mjekësore të klasës 1, të lëshuar në përputhje me aneksin IV (pjesa-MED) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar;

e) në rastin e aeroplanëve, përveç kërkesave në pikat (a) deri (d), të përputhen me kërkesat e përvojës të përcaktuara në tabelën 1 të aneksit të kësaj rregulloreje;

f) në rastin e helikopterëve, përveç kërkesave në pikat (a) deri (d), të përputhen me kërkesat e përvojës të përcaktuara në tabelën 2 në aneksin e kësaj rregulloreje.

Neni 6

Licencat e pilotit për aktivitete jotregtare me kategorizim instrumental

Për validimin e licencës së pilotit privat me një kategorizim instrumenti, ose licencës së pilotit tregtar (‘CPL’), si dhe licencës së pilotit të transportit të linjës ajrore (‘ATPL’) me një kategorizim instrumenti, në rastet kur pilotët synojnë të ushtrojnë vetëm privilegje të pilotit privat, mbajtësit duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) të kryejnë testin e aftësisë për kategorizimin e klasës ose tipit dhe e kategorizimit të instrumentit në lidhje me privilegjet e licencës së mbajtur, në përputhje me Shtojcën 7 dhe shtojcën 9 të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij, që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011 dhe ndryshimet e saj;

b) të demonstrojnë njohuritë e legjislacionit për transportin ajror, kodeve aeronautike të motit, planifikimit dhe performancës së fluturimit (IR) dhe performancës njerëzore;

c) të demonstrojnë aftësi gjuhësore në përputhje me FCL.055 të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e

rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësimi të tij, që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011 dhe ndryshimet e saj;

d) të kenë të paktën një certifikatë të vlefshme mjekësore të klasit 2, të lëshuar në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos;

e) të ketë një përvojë minimale prej të paktën 100 orësh fluturimi me instrumente si pilot në komandë (‘PIC’) në kategorinë përkatëse të avionit.

Neni 7

Licencat e pilotëve për aktivitetet tregtare pa kategorizim instrumental

Për vlefshmërinë e licencave të pilotëve privatë, ose licencat CPL dhe ATPL pa një kategorizim instrumental kur piloti synon të ushtrojë vetëm privilegjet e pilotit privat, mbajtësit duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) të demonstrojnë njohuri për ligjin e ajrit dhe performancën njerëzore;

b) të kalojnë testin e aftësisë për licencën private të pilotit (‘PPL’) siç përcaktohet në pikën FCL.235 të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar;

c) të përmbushin kërkesat përkatëse të nënpjesës H të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar, për lëshimin e kategorizimit të një tipi ose klase, të rëndësishme për privilegjet e licencës së mbajtur;

d) të kenë të paktën një certifikatë mjekësore të klasit 2, të lëshuar në përputhje me aneksin I të Konventës së Çikagos;

e) të demonstrojnë aftësi të gjuhës në përputhje me FCL.055 të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrit të Ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që



transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar;

f) të kenë një përvojë, minimalisht prej të paktën 100 orë si pilot në kategorinë përkatëse të avionit.

Neni 8

Validimi i licencave të pilotëve për detyra specifike me kohëzgjatje të kufizuar

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve të mësipërme, në rastin e fluturimeve të prodhuesve, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të pranojë një licencë të lëshuar në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos nga vende që s'janë vende të BE-së, ose ZPEA-së për një periudhë maksimale prej muaj 12 për detyra specifike me kohëzgjatje të kufizuar, të tilla si: fluturime instruktimi për hyrjen fillestare në shërbim, demonstrime, fluturime testuese ose pa pasagjerë (*ferry*), me kusht që aplikuesi të plotësojë kërkesat e mëposhtme:

a) zotëron një licencë të përshtatshme dhe certifikatën mjekësore dhe kategorizimet ose kualifikimet përkatëse të lëshuara në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos;

b) është i punësuar, drejtpërdrejtë ose indirekt, nga një prodhues avioni ose nga një autoritet i aviacionit. Në këtë rast, privilegjet e mbajtësit do të kufizohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil në kryerjen e instruksioneve të fluturimit dhe testimin për lëshimin fillestar të kategorizimit të tipit, mbikëqyrjen e fluturimit fillestar të linjës nga pilotët e operatorëve, fluturimet pa pasagjerë (*ferry*), fluturimet fillestare të linjës, demonstrimet e fluturimit ose fluturimet testuese, sipas rastit me detyrat e parashikuara në këtë paragraf.

2. Në shmangie nga nenet 4 deri në 7, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të qëllim të konkurseve të fluturimit ose shfaqjeve të fluturimeve me kohëzgjatje të kufizuar të validojë një licencë të lëshuar nga një vend i tretë duke lejuar mbajtësin të ushtrojë privilegjet e një PPL-je sipas specifikimeve në aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar, licencën e pilotit të balonave (BPL) siç specifikohet në aneksin III (pjesa-BFCL) të rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e

balonave”, që transponon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/395 ose një licencë piloti për planer (SPL) siç specifikohet në aneksin III (pjesa-SFCL) të rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e”, që transponon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/1976, me kusht që të gjitha kërkesat e mëposhtme të plotësohen:

a) para eventit, organizatori i konkursit ose shfaqjes së fluturimit i jep Autoriteti i Aviacionit Civil evidencat e përshtatshme që të sigurojë që piloti do të jetë i familjarizuar me informacionin përkatës të sigurisë dhe të menaxhojë çdo rrezik që lidhet me fluturimet;

b) aplikanti mban një licencë dhe certifikatë mjekësore të përshtatshme dhe kategorizime ose kualifikime përkatëse të lëshuara në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos.

3. Pavarësisht dispozitave të neneve 4 deri në 7, Autoriteti i Aviacionit Civil mund të validojë një licencë që është ekuivalente me atë të referuar në paragrafin 2 dhe të lëshuar në përputhje me kërkesat e aneksit 1 të Konventës së Çikagos nga një vend i tretë për një maksimum prej 28 ditësh në vit kalendarik, për detyra të veçanta jo tregtare, me kusht që aplikuesi të përmbushë të gjitha kërkesat e mëposhtme:

a) mban një licencë dhe certifikatë mjekësore të përshtatshme, si dhe kategorizimet ose kualifikimet përkatëse të lëshuara në përputhje me aneksin 1 të Konventës së Çikagos;

b) ka përfunduar të paktën një fluturim familjarizimi, për qëllim të sinkronizimit të kohës lokale, me një instruktor të kualifikuar para kryerjes së detyrave specifike me kohëzgjatje të kufizuar.

Seksioni 3

Konvertimi i licencave

Neni 9

Kushtet për konvertimin e licencave

1. Autoriteti i Aviacionit Civil mund të konvertojë një licencë për kategorinë përkatëse të avionit, në një PPL në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar me një kategorizim klase



ose tipi me një pilot të vetëm, një BPL në përputhje me aneksin III (pjesa-BFCL) të rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e balonave”, që transponon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/395 ose një SPL në përputhje me aneksin III (pjesa-SFCL) të rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave”, që transponon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/1976, kur licenca origjinale është lëshuar në përputhje me kërkesat e aneksit 1 të Konventës së Çikagos nga vende që s’janë vende të BE-së, ose ZPEA-së sipas përcaktimeve të Marrëveshjes Shumëpalëshe dhe licenca është, në mënyrë alternative:

a) një licencë ekuivalente me licencat e referuara në paragrafin 1;

b) një CPL ose një ATPL.

2. Mbajtësi i licencës që do të konvertohet duhet të plotësojë kërkesat minimale të mëposhtme për kategorinë përkatëse të avionëve:

a) të kalojë një provim me shkrim në ligjin e ajrit dhe performancën njerëzore;

b) të kalojë me sukses testin përkatës të aftësisë PPL, BPL ose SPL, në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar, aneksin III (pjesa-BFCL) të rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për funksionimin e balonave”, që transponon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/395 ose aneksin III (pjesa-SFCL) të rregullores “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për operimet e planerave”, që transponon rregulloren evropiane (EU) nr. 2018/1976;

c) të përmbushë kërkesat për lëshimin e kategorizimit përkatës të tipit ose klasës, në përputhje me nënpjesën H;

d) të mbajë një certifikatë mjekësore, siç kërkohet dhe të lëshohet në përputhje me aneksin IV (pjesa-MED) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar;

e) të demonstrojë aftësi gjuhësore në përputhje me FCL.055 të aneksit I (pjesa-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar;

f) të ketë kryer të paktën 100 orë kohë fluturimi si pilot.

Seksioni 4

Pranimi i kategorizimit të klasës dhe tipit

Neni 10

Kushtet për pranimin e kategorizimit të klasës dhe tipit

Një kategorizim i vlefshëm i klasës ose tipit i vendosur në një licencë të lëshuar nga vende që s’janë vende të BE-së mund të vendoset në një licencë të lëshuar në përputhje me aneksin I (pjesa-FCL) të urdhrin të ministrit nr. 178, datë 20.12.2023, “Për miratimin e rregullores ‘Për kërkesat teknike dhe procedurat administrative në lidhje me ekuipazhin ajror të aviacionit civil’”, apo çdo përditësim të tij që transponon rregulloren (BE) nr. 1178/2011, të ndryshuar, me kusht që aplikuesi:

a) të jetë në përputhje me kërkesat e eksperiencës dhe parakushtet e aplikuar për lëshimin e kategorizimit të tipit ose klasës në përputhje me pjesën-FCL;

b) të kalojë testin përkatës të aftësive për lëshimin e tipit ose klasës së aplikueshme në përputhje me pjesën-FCL;

c) është në praktikë aktuale të fluturimit;

d) ka jo më pak se:

i. për kategorizimin e klasës së aeroplanëve, 100 orë përvojë fluturimi si pilot në atë klasë;

ii. për kategorizimin e tipit të aeroplanëve, 500 orë përvojë fluturimi si pilot në atë tip;

iii. për helikopterët me një motor me një masë maksimale të certifikuar të ngritjes deri në 3 175 kg, 100 orë përvojë fluturimi si pilot në atë tip;

iv. për të gjithë helikopterët e tjerë, 350 orë përvojë fluturimi si pilot në atë tip.



ANEKS
KUSHTET PËR PRANIMIN E LICENCAVE TË LËSHUARA NGA OSE NË EMËR TË
VENDEVE TË TRETA

Tabela 1. Kërkesat e eksperiencës për aeroplanët

Licenca e mbajtur	Eksperienca totale e orëve të fluturimit	Privilegjet	
(1)	(2)	(3)	
ATPL(A)	> 1 500 orë si PIC në avionë me shumë pilotë	Transport ajror tregtar në avionë me shumë pilotë si PIC	(a)
ATPL(A) ose CPL(A)/IR (*)	> 1 500 orë si PIC ose bashkëpilot në avionë me shumë pilotë sipas kërkesave të operimeve.	Transport ajror tregtar në avionë me shumë pilotë si bashkëpilot	(b)
MPL	> 1 500 orë si bashkëpilot në avionë me shumë pilotë sipas kërkesave operacionale	Transport ajror tregtar në avionë me shumë pilotë si bashkëpilot	(ba)
CPL(A)/IR	> 1 000 orë si PIC në transportin ajror tregtar deri sa të përftojë një IR	Transport ajror tregtar në avionë me pilot të vetëm si PIC	(c)
CPL(A)/IR	> 1 000 orë si PIC ose si bashkëpilot në avionë me pilotë të vetëm sipas kërkesave të operimeve	Transportit ajror tregtar në avionë me pilot të vetëm si bashkëpilot sipas kërkesave operacionale	(d)
ATPL(A), CPL (A)/IR, CPL(A)	> 700 orë në avionë të tjerë përveç TMGs, duke përfshirë 200 orë në rolin e aktivitetit për të cilin është kërkuar pranimi, dhe 50 orë në atë rol në të paktën 12 muajt e fundit	Ushtrimi i privilegjeve në avionë në operime të tjera përveç transportit ajror tregtar	(e)
CPL(A)	> 1 500 orë si PIC në Transportin ajror tregtar duke përfshirë 500 orë në operime avione deti	Transporti ajror tregtar në avionë me pilotë të vetëm si PIC	(f)

(*) Mbajtësit CPL(A)/IR në aeroplanë me shumë pilot duhet të kenë demonstruar njohuri të nivelit të ICAO ATPL(A) përpara pranimit.

Tabela 2. Kërkesat e eksperiencës për helikopterë

Licenca e mbajtur	Eksperienca e orëve totale të fluturimit	Privilegjet	
(1)	(2)	(3)	
ATPL(H) IR e vlefshme	> 1 000 orë si PIC në helikopterët me shumë pilotë	Transporti ajror komercial në helikopterët me shumë pilotë si PIC në operacionet VFR dhe IFR	(a)
ATPL(H) jo privilegje IR	> 1 000 orë si PIC në helikopterët me shumë pilotë	Transporti ajror komercial në helikopterët me shumë pilotë si PIC në operacionet VFR	(b)
ATPL(H) IR e vlefshme	> 1 000 orë si pilot në helikopterët me shumë pilotë	Transporti ajror tregtarë në helikopterë me shumë pilotë si bashkëpilot në operimet VFR dhe IFR	(c)
ATPL(H) jo privilegje IR	> 1 000 orë si pilot në helikopterët me shumë pilotë	Transporti ajror tregtar në helikopterë me shumë pilotë si bashkëpilot në operacionet VFR	(d)
CPL(H)/IR (*)	> 1 000 orë si pilot në helikopterët me shumë pilotë	Transporti ajror komercial në helikopterë me shumë pilotë si bashkëpilot	(e)
CPL(H)/IR	> 1 000 orë si PIC në transportin ajror që nga marrja e IR	Transporti ajror komercial në helikopterë me pilot të vetëm si PIC	(f)
ATPL(H) me ose pa privilegje IR, CPL(H)/IR, CPL(H)	> 700 orë në helikopterë të ndryshëm nga ato të certifikuar sipas CS-27/29 ose ekuivalente, duke përfshirë 200 orë në rolin e aktivitetit për të cilin pranimi kërkohej, dhe 50 orë në atë rol në 12 muajt e fundit	Ushtrimi i privilegjeve në helikopterë në operime të ndryshme nga ato të transportit ajror komercial	(g)

(*) Mbajtësit CPL(H)/IR në helikopterë me shumë pilot duhet të kenë demonstruar njohuri të nivelit të ICAO ATPL(H) përpara pranimit.



VENDIM
Nr. 67, datë 6.12.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj,	kryetare;
Marsida Xhaferllari,	anëtare;
Fiona Papajorgji,	anëtare;
Elsa Toska,	anëtare;
Sonila Bejtja,	anëtare;
Illir Toska,	anëtar;
Genti Ibrahimimi,	anëtar;
Marjana Semini,	anëtare;
Sandër Beci,	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 6.12.2023,
mori në shqyrtim në seancë mbi bazë të
dokumenteve çështjen nr. 4 (P) 2023, që u përket:

KËRKUES: Pëllumb Çela, Shoqëria “Çela-X”
sh.p.k.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Arjan Avllaj, Shoqëria “Ani” sh.p.k., përfaqësuar
me prokurë nga avokat Dorian Çeliku.

Shoqëria “Alba Ceramica N” sh.p.k., në
mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 9577,
datë 6.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor
Tiranë; nr. 433, datë 16.10.2015, të Gjykatës së
Apelit Tiranë; nr. 00-2016-2892, datë 11.11.2016, të
Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë; nr. 163, datë
29.6.2017, të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, si të
papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së
Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1,
shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të
Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*);
neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e
Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për
organizimin dhe funksionimin e Gjykatës
Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i
ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori
në shqyrtim pretendimet e Pëllumb Çelës, i cili është
edhe administrator i shoqërisë “Çela-X” sh.p.k.
(*kërkesit*), që kanë kërkuar pranimin e kërkesës,

prapësimet e subjektit të interesuar Arjan Avllaj, i cili
është edhe administrator i shoqërisë “Ani” sh.p.k.
(sot “Hotel Austria” sh.p.k.), që ka kërkuar rrëzimin
e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të
shoqërisë “Alba Ceramica N” sh.p.k., si dhe diskutoi
çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Pëllumb Çela, i cili paraqitet në
cilësinë e personit fizik, është edhe administrator e
ortak i vetëm i kërkuesit tjetër shoqërisë “Çela-X”
sh.p.k. (*“Çela-X” sh.p.k.*), që ka si objekt veprimtarie
projektimin, ndërtimin e objekteve civile, industriale,
turistike etj.

2. Subjekti i interesuar Arjan Avllaj paraqitet në
cilësinë e personit fizik, por është edhe administrator
e ortak i vetëm i subjektit tjetër të interesuar,
shoqërisë “Ani” sh.p.k. (*“Ani” sh.p.k.*), që në objekt
të veprimtarisë, për periudhën e referuar të
mosmarrëveshjes, ka pasur import-eksport, tregtim
me shumicë dhe pakicë të mallrave industriale,
ndërtimore, prodhim të materialeve të ndërtimit,
inerteve, si gurë, rërë, granil, soleta të tipeve të
ndryshme etj.

3. Me vendimin nr. 48, datë 13.6.2002, Këshilli i
Rregullimit të Territorit pranë Bashkisë Tiranë
(*KRRT*) ka miratuar lejen për shesh ndërtimi për
objekt 4, 6, 8 dhe 12-katësh, me 2 kate parkimi
nëntokë, në rrugën “Qemal Stafa”, në truallin në
pronësi të disa familjeve. Në vijim, me vendimin nr.
19, datë 12.7.2002, *KRRT*-ja ka miratuar lejen e
ndërtimit në favor të shoqërisë ndërtuese “Trema
Inginiering 2” sh.p.k. (*“Trema Inginiering 2” sh.p.k.*), e
cila kishte lidhur marrëveshje me pronarët e truallit.

4. Më datë 30.12.2002, subjekti i interesuar Arjan
Avllaj, shtetasi I.T. (ortak dhe administrator i
“Trema Inginiering 2” sh.p.k.) dhe shtetasja D.K.
kanë lidhur marrëveshjen “Financimi veprimtarie
ndërtuese”, duke rënë dakord për të qenë partnerë
financues të veprimtarisë ndërtimore në lidhje me
ndërtimin e objektit si më lart dhe konkretisht:
subjekti i interesuar Arjan Avllaj në masën 67,5%,
shtetasi I.T. në masën 22,5% dhe shtetasja D.K. në
masën 10%, ndërkohë që “Trema Inginiering 2”
sh.p.k. do të ishte në cilësinë e sipërmarrësit në
ndërtim. Sipas marrëveshjes, ndarja e të ardhurave



nga shitja e objektit do të bëhej mes partnerëve financues, pasi në llogarinë e tyre të përbashkët do të depozitohej një shumë e caktuar (1 milion dollarë amerikanë), ku fillimisht do të shlyheshin shumat e financuara dhe, më pas, do të ndaheshin të ardhurat e realizuara në raport me përqindjen e financimit.

5. Më datë 1.10.2003, midis sipërmarrësit “Trema Injineri 2” sh.p.k. dhe kërkuesit “Çela-X” sh.p.k. është nënshkruar marrëveshja për kalimin e të drejtave dhe detyrimeve të rrjedhura nga leja e ndërtimit, duke marrë në dorëzim shoqëria e dytë punimet e kryera deri në atë moment kohor. Po më datë 1.10.2003, midis subjektit të interesuar Arjan Avllaj, njëherazi ortak dhe administrator i subjektit tjetër të interesuar “Ani” sh.p.k., nga njëra anë, dhe kërkuesit Pëllumb Çela, njëherazi ortak dhe administrator i kërkuesit tjetër “Çela-X” sh.p.k., nga ana tjetër, është lidhur një marrëveshje sipas së cilës Arjan Avllaj ka marrë përsipër financimin e punimeve të ndërtimit në masën 90%, ndërsa Pëllumb Çela në masën 10%, ku në të njëjtën masë do të ndaheshin edhe fitimet mes tyre. Ndërkohë që “Çela-X” sh.p.k. do të ishte sipërmarrësi që do të realizonte ndërtimin e objektit dhe nuk përfitonte fitime, pasi nuk punonte me normë fitimi për sipërmarrjet, përderisa ishte partner në financim. Me vendimin nr. 305, datë 5.7.2004, KRRT-ja ka miratuar kalimin e lejes së ndërtimit në favor të “Çela-X” sh.p.k., si subjekt ndërtues, pasi kishte nënshkruar marrëveshjet me pronarët e truallit si kusht për kalimin e saj.

6. Gjatë zbatimit të lejes së ndërtimit dhe marrëveshjes së financimit mes palëve kanë lindur mosmarrëveshje për sa u përket vlerave të financimit, të cilat janë tejkalluar nëpërmjet marrëveshjes së datës 23.2.2006, përmes së cilës palët kanë rënë dakord që subjekti i interesuar Arjan Avllaj të merrte përsipër të gjitha detyrimet financiare për përfundimin e objektit, përfshirë detyrimet financiare ndaj shtetit dhe pagesat për regjistrimin e objektit. Nga ana tjetër, kërkuesi “Çela-X” sh.p.k., në cilësinë e ndërtuesit të objektit, merrte përsipër të lidhte të gjitha kontratat me pronarët e truallit dhe blerësit, të bënte rakordimin përfundimtar të objektit, të plotësonte dokumentacionin teknik dhe ta dorëzonte atë në momentin e aktit të shfrytëzimit.

7. Në vitin 2007, ndërsa objekti ndërtimor ka përfunduar, kërkuesi “Çela-X” sh.p.k. ka aplikuar pranë Bashkisë Tiranë për t’u pajisur me leje

shfrytëzimi të objektit, moment në të cilin mes palëve kanë lindur sërish mosmarrëveshje. Subjekti i interesuar Arjan Avllaj ka depozituar kallëzim penal edhe ndaj kërkuesve për veprat penale “Mashttrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, me pretendimin se në kundërshtim me marrëveshjen e datës 23.2.2006, me qëllim përfitimin e pasurisë së tij me anë të mashttrimit, të kallëzuarit kanë përpiluar një sërë kontratash shitjeje të sipërfaqeve të banimit, të panoterizuara, të paregjistruara dhe pa data. Mbi këtë kallëzim ka filluar një procedim penal, në përfundim të të cilit, ndër të tjerë, kërkuesi Pëllumb Çela është akuzuar për veprat penale “Mashttrimi” dhe “Falsifikimi i dokumenteve”, për të cilat është dërguar për gjykim. Me vendimin nr. 311, datë 29.2.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, ka vendosur deklarinë të pafajshëm të kërkuesit, me arsyetimin se fakti i provuar në gjykim nuk përmbante elementet e figurës së veprës penale të mashttrimit, ndërsa mes kallëzuesit dhe kërkuesit ekzistonte një konflikt juridiko-civil në lidhje me investimet e bëra për ndërtimin e objektit, kontributin e secilit partner dhe pjesët e tyre takuese, të cilin duhej ta zgjidhnin civilisht. Ndërsa për sa i përket veprës penale “Falsifikimi i dokumenteve”, gjykata ka arsyetuar se subjekt i përgjegjësishë penale duhej të ishte personi juridik (“Çela-X” sh.p.k.), por edhe nëse kërkuesi do të ishte subjekt i kësaj vepre penale, mungon elementi i dashjes nga kërkuesi për kryerjen e kësaj vepre. Ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar.

8. Ndërkohë, më datë 8.2.2012 subjekti i interesuar Arjan Avllaj ka vënë në lëvizje një proces gjyqësor civil. Në kërkesëpadinë e tij, duke paditur të dy kërkuesit, pas pakësimit të objektit të padisë gjatë veprimeve përgatitore, ai ka kërkuar: (1) kthimin e sendeve (8 njësi individuale të objektit ndërtimor - vendparkime, zyra dhe apartamente); (2) shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm dhe vonesa në dorëzimin e sendeve. Gjatë gjykimit, mbi kërkesën e subjektit të interesuar “Ani” sh.p.k., është lejuar pjesëmarrja e tij në cilësinë e ndërhyrësit kryesor (bashkëpaditës), me të njëjtat kërkitime si dhe paditësi Arjan Avllaj. Po ashtu, është lejuar pjesëmarrja në gjykim si ndërhyrëse kryesore edhe e shoqërisë “Alba Ceramica N” sh.p.k., e cila ka kërkuar ndaj të paditurit “Çela-X” sh.p.k. përmbushjen e detyrimit kontraktor për pagimin e çmimit të mallrave në vlerën 93.166 euro dhe të kamatëvonesave për këtë vlerë.



9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9577, datë 6.10.2014, ka pranuar pjesërisht padinë e bashkëpaditësve (subjekteve të interesuara) Arjan Avllaj dhe “Ani” sh.p.k., duke detyruar të paditurit (kërkuesit) Pëllumb Çela dhe “Çela-X” sh.p.k.: (1) t’iu dorëzojnë atyre në natyrë 5 njësi individuale të objektit ndërtimor, që posedoheshin nga kërkuesi Pëllumb Çela mbi bazën e kontratave të shitjes absolutisht të pavlefshme; (2) t’iu paguajnë atyre vlerën e 3 njërive individuale të tjera të objektit ndërtimor, që në bazë të kontratave të shitjes posedoheshin nga të tretët, respektivisht vlerat 92.820.000 lekë, 20.153.000 lekë dhe 27.318.000 lekë; (3) t’iu paguajnë atyre përfitimet në të holla nga dhënia me qira e 1 njësie individuale të objektit ndërtimor të poseduar nga kërkuesi Pëllumb Çela, në vlerën 140.070 euro e llogaritur deri në qershor të vitit 2014 dhe pas kësaj date në vlerën 1.610 euro në muaj deri në ekzekutimin e vendimit. Për pjesën tjetër të padisë gjykata ka vendosur rrëzimin e saj. Po ashtu, gjykata ka pranuar edhe padinë e ndërhyrësit kryesor “Alba Ceramica N” sh.p.k.

10. Mbi ankimin e të paditurve Pëllumb Çela dhe “Çela -X” sh.p.k. (kërkuesve), pasi ka përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor dhe administruar si provë vendimin penal nr. 1271, datë 3.7.2015, të dhënë nga kjo gjykatë kundër kërkuesve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 433, datë 16.10.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me pranimin e padisë së bashkëpaditësve Arjan Avllaj dhe “Ani” sh.p.k. (subjekteve të interesuara), si dhe prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit të çështjes për sa i takonte padisë së ndërhyrësit kryesor “Alba Ceramica N” sh.p.k. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs të paditurit (kërkuesit) Pëllumb Çela dhe “Çela -X” sh.p.k.

11. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2016-2892, datë 11.11.2016, ka vendosur mospranimin e rekursit, me arsyetimin se ai nuk përmbushte kriteret e parashikuara nga ligji, pasi nuk përmbante asnjë prej rasteve të përcaktuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile (KPC).

12. Më datë 23.11.2016 hynë në fuqi ndryshimet ligjore të ligjit nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”” (ligji nr. 99/2016). Një prej ndryshimeve lidhej me zbatimin

e afatit të ri për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, afat i cili u ndryshua nga 2 vjet në 4 muaj (shkronja “b” e pikës 1 të nenit 71/a, të shtuar), ndërkohë që në dispozitën kalimtare të ndryshuar (pikën 3 të nenit 86), ndër të tjera, u përcaktua se për rastin e parashikuar në nenin 71/a, zbatimi i ligjit ndryshues do të fillonte më datë 1 mars 2017.

13. Kërkuesit më datë 2.6.2017 i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 9577, datë 6.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 433, datë 16.10.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2016-2892, datë 11.11.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 163, datë 29.6.2017, ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim, me arsyetimin se kërkesa ishte paraqitur pas kalimit të afatit ligjor 4-mujor.

14. Në vijim, kërkuesi Pëllumb Çela i është drejtuar me kërkesë Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) (aplikimi nr. 73274/17 Çela kundër Shqipërisë), duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi duhej të ishte zbatuar afati dyvjeçar për paraqitjen e kërkesës, sepse vendimi i Gjykatës së Lartë mbante datën 11.11.2016, pra përpara datës 1 mars 2017 kur kishte hyrë në fuqi afati i ri 4-mujor. GJEDNJ-ja, me vendimin e datës 29.11.2022 (bërë përfundimtar më datë 28.2.2023), ka deklaruar të pranueshme kërkesën në lidhje me të drejtën e ankuesit për t’iu drejtuar Gjykatës, duke konstatuar se ka pasur shkelje të nenit 6§1 të KEDNJ-së në drejtim të së drejtës së aksesit, pasi zbatimi i kufizimeve procedurale nga Gjykata nuk ishte mjaftueshëm i qartë dhe i parashikueshëm nga këndvështrimi i kërkuesit. Sipas saj, ligji i ri (ligji nr. 99/2016) ka krijuar pasiguri për mënyrën me të cilën është përllogaritur afati i ri për paraqitjen e kërkesës dhe një gjë e tillë ngrinte nevojën për sqarim nga Gjykata për metodën ekzakte që do të përdorej për përllogaritjen e afatit (shih paragrafin 35 të vendimit të GJEDNJ-së).

15. Pas vendimit të GJEDNJ-së, më datë 24.4.2023 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës me kërkesë për rihapjen e procesit të përfunduar me vendimin e moskalimit për shkak të moslegjitimitetit *ratione temporis*, duke kërkuar shqyrtimin në themel të vendimeve të dhëna gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në të tria shkallët e gjyqësorit dhe të



përfunduar me vendimin nr. 00-2016-2892, datë 11.11.2016 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

16. Kolegji i Gjykatës, me vendimin e datës 31.5.2023, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila më datë 19.6.2023 ka vendosur pranimin e kërkesës për rihapjen e procesit dhe shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të kërkuësve në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve. Në pranimin e kërkesës për rihapje, Mbledhja e Gjyqtarëve ka vlerësuar se sipas nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr. 8577/2000, nëse Gjykata ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë të paraqesë kërkesë për rihapjen e procesit gjyqësor, e cila paraqitet brenda 4 muajve nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare. Kërkesa duhet të përmbajë një përmbledhje të vendimit të gjykatës ndërkombëtare me çështjet kryesore që ka konstatuar ajo gjykatë, kërkimet konkrete dhe kërkuesi duhet të kërkojë shprehimisht rihapjen e procesit, si dhe shfuqizimin e aktit.

17. Në lidhje me afatin për paraqitjen e kërkesës, Mbledhja e Gjyqtarëve ka arsyetuar se llogaritja e afatit 4-mujor do të fillojë nga hyrja në fuqi e vendimit të gjykatës ndërkombëtare, pra nga botimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 71/c, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 6, shkronja “dh”, të ligjit nr. 78/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Qendrës së Botimeve Zyrtare”. Vendimi i GJEDNJ-së për çështjen “Çela kundër Shqipërisë” është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 5.4.2023 dhe kërkuessit i janë drejtuar Gjykatës më datë 24.4.2023, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/c, pika 4, i ligjit nr. 8577/2000.

18. Kërkuessit, përveç shkaqeve që lidhen me rihapjen e procesit të zhvilluar nga kjo Gjykatë, kanë parashtruar edhe pretendime që lidhen me procesin e themelit dhe vendimmarrjen e gjykatave të zakonshme, të cilat kërkojnë që t'i nënshtrohen këtij gjykimi. Sipas vlerësimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve, qëllimi i kërkesës, në kuptim të nenit 71/c të ligjit nr. 8577/2000, është rivendosja e kërkuësve në situatën që ishin para shkeljes së konstatuar, çka nënkupton se kërkesa për rihapje procesi nuk u jep të drejtën

atyre të paraqesin një ankim të ri kushtetues, me shkaqe të reja ose të ndryshme nga ato që kanë paraqitur në kërkesën me të cilën kanë vënë në lëvizje procesin për të cilin kërkojnë rihapjen. Në rastin konkret, procesi në Gjykatë ka përfunduar për shkak të moslegjitimitit *ratione temporis*, duke mos vijuar më tej me shqyrtimin e çështjes, ndaj Gjykata, pas rihapjes së procesit me vendimin e Mbledhjes së Gjyqtarëve, do të vijojë me analizën e legjitimitit *ratione materiae* të kërkuësve, çka do të thotë në të njëjtën fazë në të cilën ka qenë procesi i gjetur nga GJEDNJ-ja në kundërshtim me KEDNJ-në.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

19. **Kërkuessit**, në mënyrë të përmbledhur, në lidhje me themelin e procesit gjyqësor kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim, të:

19.1. *Së drejtës së aksesit dhe të ankimit efektiv*, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duke vendosur mospranimin e rekursit nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuësve, megjithëse ato kishin të bënë me zbatimin e gabuar të ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulëta dhe konkretisht: - gjykata e shkallës së parë ka pranuar për shqyrtim një padi të pashoqëruar me provat përkatëse, e cila duhej të ishte kthyer në momentin e paraqitjes së saj në respektim të nenit 158/a të KPC-së; - gjykata e shkallës së parë ka pranuar për shqyrtim kërkesën për ndërhyrje kryesore të “Ani” sh.p.k., e cila nuk është shoqëruar me kërkesëpadi, çka është në shkelje të neneve 153, 154, 156, 158/a dhe 189 të KPC-së; - gjykata e shkallës së parë ka zbatuar gabim nenin 224/b të KPC-së, kur nuk ka marrë për bazë konkluzionet e ekspertit kontabël, por ka bërë vetë përllogaritje për përcaktimin e fitimit në një pallat shumëkatësh, të cilat janë të gabuara, në lajthitje matematikore dhe ekonomike; - gjykata e shkallës së parë nuk ka zbatuar ligjin për sa i përket ndërgjyqësisë, ndërsa në gjykim nuk janë thirrur, sipas nenit 193 të KPC-së, personat porositës (N.P., L.D., D.D. dhe I.D.), sipas kontratave të shitjes të konstatuara prej saj si absolutisht të pavlefshme; - gjykatat kanë disponuar përtej kërtimeve të padisë në lidhje me disponimin e dytë, ato nuk kanë gjykuar mosmarrëveshjen e ngritur nga paditësi përmes padisë së rivendikimit, por kanë hetuar në drejtim të përmbushjes së detyrimeve kontraktore, në shkelje



të neneve 5 dhe 6 të KPC-së; - gjykatat e kanë pranuar padinë në shkellje të nenit 29 të KPC-së, pasi nuk ka asnjë provë për fitimin e pronësisë nga paditësi për pasuritë e rivendikuara, ato nuk kanë bërë hetim gjyqësor në lidhje me investimin e pretenduar nga paditësi, i cili, në fakt, nuk ka investuar asnjë vlerë monetare; - gjykata e apelit në mënyrë të gabuar ka barazuar cilësinë e investitorit me atë të pronarit të ndërtimit, cilësi këto që pasjellin të drejta të ndryshme, pasi e drejta e investitorit nuk është e drejtë pronësie, por e drejtë për të përfutur fitim në raport me masën e investimit dhe jo të drejta pronësie për pasurinë e paluajtshme; - gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin kur kanë pranuar legjitimitimin pasiv të kërkuesit Pëllumb Çela, i cili nuk mban përgjegjësi për detyrimet kontraktore të shoqërisë “Çela-X” sh.p.k. Vendimi i Gjykatës së Apelit Tiranë është alogjik dhe nuk është i qartë në formë e në përmbajtje.

19.2 *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi çështja në shkallë të parë, për shkak të vlerës së padisë (mbi 1 milion euro), duhej të gjykohej me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë, ndërkohë që është gjykuar nga një gjyqtar. Në procesverbalin e seancës përgatitore nuk gjendet e pasqyruar kërkesa e kërkuesve për gjykimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Në të nuk ka as shënim për marrjen e mendimit të palëve për formimin e trupit gjykues, ndërkohë që kjo është një nga detyrat e gjykatës sipas neneve 35 dhe 158/a të KPC-së. Pretendimi është ngritur në ankim dhe në rekurs, por gjykatat nuk e kanë analizuar atë.

19.3 *Së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme*, pasi gjyqtari i çështjes në shkallë të parë ka treguar njëanshmëri, pasi në mënyrë të qëllimshme nuk ka pasqyruar kërkesën e të paditurve për gjykimin e çështjes me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë dhe ka lejuar gjykimin e saj pa paguar paditësi taksën gjyqësore sipas vlerës së objektit të padisë. Për shkak të njëanshmërisë së tij, kërkuesit kanë paraqitur tri kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes, të cilat nuk janë pranuar. Megjithatë pretendimet për njëanshmëri janë parashtruar në ankim, gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë të gabuar se nuk provohej njëanshmëria. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhej ta kishte marrë në analizë këtë pretendim dhe jo të mbyllte çështjen me mospranimin e rekursit.

19.4 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat duke vendosur pranimin e padisë u kanë mohuar kërkuesve të drejtën e pronësisë. Aktet administrative (leja e ndërtimit, aktkontrolli dhe leja e përdorimit) që kanë mundësuar realizimin e ndërtimit të ri, disponohen nga shoqëria “Çela-X” sh.p.k., duke i dhënë asaj titullin e pronësisë për pallatin shumëkatësh, akte të cilat vijojnë të jenë në fuqi, për sa kohë nuk janë ndryshuar nga organi administrativ ose me vendim gjyqësor të formës së prerë.

20. ***Subjekti i interesuar, Arjan Avllaj, administrator i shoqërisë “ANI” sh.p.k., ka prapësuar:***

20.1 Pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe të ankimit efektiv në gjykatë është i pabazuar, pasi vendimi i marrë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është në respektim të së drejtës për proces të rregullt ligjor. Në asnjë rast nuk është paraqitur në rekurs ndonjë shkelje ligjore materiale ose procedurale e rëndë apo e tillë që ka ndikuar në dhënien e vendimit. Pretendimet janë rrëzuar në mënyrë shteruese nga Gjykata e Apelit Tiranë.

20.2 I pabazuar është edhe pretendimi për gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj. Këtë pretendim Gjykata e Apelit Tiranë e ka rrëzuar si të pabazuar.

20.3 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk qëndron, pasi gjatë gjykimit është provuar se pretendimi ishte tërësisht i pavërtetë. Edhe Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se asnjë prej kërkesave për përjashtimin e gjyqtarit nuk ishte e bazuar në ligj.

20.4 Pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk qëndron, pasi shoqëria “ÇELA-X” sh.p.k. nuk ka pasur titull pronësie të regjistruar. Gjykatat kanë hetuar dhe arritur në përfundimin se shoqëria ka pasur cilësinë e ndërtuesit sipërmarrës. Gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë të plotë edhe në lidhje me ndërgjyqësinë dhe legjitimitetin pasiv / aktiv.

21. ***Subjekti i interesuar, “Alba Ceramica N” sh.p.k., nuk ka paraqitur prapësime me shkrim, megjithatë është njoftuar rregullisht.***

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për themelin e pretendimeve

22. Gjykata vëren se kërkuesit kanë argumentuar, në mënyrë të përmbledhur, se gjykatat nuk u kanë



dhënë përgjigje pretendimeve të ngritura në ankim dhe në rekurs, të cilat ishin të lidhura kryesisht me zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural dhe me formimin e trupit gjykues gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për shkak të vlerës së padisë.

23. Për sa më lart, Gjykata mbështetur në thelbin e argumenteve të parashtruara dhe natyrën e tyre, që lidhet me qëndrimin e mbajtur nga gjykatat gjatë gjykimit të çështjes, çmon t'i analizojë pretendimet për cenimin e procesit të rregullt ligjor në drejtim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj gjatë gjykimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme po në gjykimin në shkallë të parë, të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor në Gjykatën e Lartë, si dhe të gjykimit të drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike, të drejta dhe parime të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës.

A.1 Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj

24. Kërkesit kanë pretenduar se çështja në shkallë të parë është gjykuar nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që, për shkak të vlerës së padisë (mbi 1 milion euro), ajo duhej të ishte gjykuar me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë, sikurse kanë kërkuar gjatë seancave përgatitore, kërkesë e cila nuk është pasqyruar në procesverbal, në të cilin nuk ka as shënim për marrjen e mendimit të palëve për formimin e trupit gjykues, në një kohë kur kjo është një nga detyrat e gjykatës sipas neneve 35 dhe 158/a të KPC-së. Pretendimi është ngritur në ankim dhe në rekurs, por gjykatat nuk e kanë analizuar atë.

25. Subjekti i interesuar Arjan Avllaj ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj është i pabazuar. Ky pretendim është ngritur në ankim dhe gjykata e apelit e ka gjetur të tillë.

26. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar për një procedurë ligjrisht të përcaktuar

dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit. Këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 12, datë 9.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në lidhje me vlerën e kërkesëpadisë, si një kusht thelbësor në përcaktimin e përbërjes së rregullt të trupit gjykues sipas dispozitave të KPC-së, Gjykata në jurisprudencën e saj ka vlerësuar se vlera e padisë përbën njëkohësisht një element esencial për të konkluduar për gjykatën kompetente. Në këtë drejtim, mosrespektimi nga ana e gjyqtarit të vetëm, në çastin e paraqitjes së padisë, të këtij rregulli procedural që kërkon zhvillimi normal i një procesi gjykimi, mund të sjellë cenimin e elementit thelbësor kushtetues që lidhet me gjykatën kompetente (*shih vendimet nr. 19, datë 25.4.2013; nr. 13, datë 18.5.2006; nr. 35, datë 12.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata vëren se neni 35, paragrafi i parë, i KPC-së, sipas përmbajtjes në momentin e paraqitjes së padisë dhe zhvillimit të veprimeve përgatitore në rastin në shqyrtim, parashikonte se gjykata e shkallës së parë gjykon me trup gjykues të përbërë nga një ose tre gjyqtarë, ndërkohë që sipas paragrafit të dytë, shkronja “a”, të këtij neni, me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë gjykohen paditë me vlerë më shumë se 20 milionë lekë vetëm nëse një nga palët e kërkon në seancë përgatitore, sipas nenit 158/a të këtij kodi.

29. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të shqyrtimit kushtetues, Gjykata konstaton se gjatë zhvillimit të veprimeve përgatitore sipas nenit 158/a të KPC-së, pikërisht në seancën e datës 20.4.2012, të paditurit (kërkesit) kanë kërkuar që paditësi (subjekti i interesuar) të përcaktonte paraprakisht vlerën e padisë, ku në varësi të saj do të kërkonin gjykimin e çështjes me trup gjykues. Gjyqtari i çështjes ka konstatuar padinë me të meta, duke i kërkuar paditësit (subjektit të interesuar) të bënte vlerësimin paraprak të objektit të saj. Procesverbali i kësaj seance përgatitore është nënshkruar rregullisht pa vërejtje nga palët dhe gjyqtari i çështjes. Pas kësaj, paditësi (subjekti i interesuar) ka ndrequr të metat e padisë duke



depozituar një akt me shkrim të titulluar “Akt vlerësimi padie”, përmes të cilit vlerën e padisë e ka përcaktuar në masën 161.207.540 lekë. Në seancën përgatitore të datës 11.5.2012, të paditurit (kërkuesit) janë përfaqësuar nga avokati S.Sh., sipas akteve përkatëse të përfaqësimit. Në këtë seancë është pranuar kërkesa e paditësit (subjektit të interesuar) për pakësimin e padisë për një nga kërkimet e saj, është dëgjuar përfaqësuesi i tij, që është shprehur se i përmbahej kërkesëpadisë, sikundër edhe përfaqësuesi i të paditurve (kërkuesve), që është shprehur për mosdakordësinë me padinë dhe se prapësimet do t'i paraqiste në seancë gjyqësore. Ndërkohë, pavarësisht se vlera e padisë ishte përcaktuar më shumë se 20 milionë lekë, asnjë nga palët nuk ka kërkuar që gjykimi i çështjes të bëhej me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë. Duke i konsideruar të ezauruara veprimet përgatitore, gjyqtari i çështjes ka vendosur kalimin e saj për shqyrtim në seancë gjyqësore. Edhe procesverbali i kësaj seance përgatitore është nënshkruar rregullisht pa vërejtje nga përfaqësuesit e palëve dhe gjyqtari i çështjes.

30. Gjykata konstaton në vijim se gjykimi në shkallë të parë i çështjes në seancë gjyqësore ka filluar më datë 12.6.2012, ndërsa trupi gjykues është formuar nga një gjyqtar i vetëm, ndërkohë që palët e pranishme, përfaqësuesit e tyre, nuk kanë shprehur kundërshtime për formimin e trupit gjykues nga një gjyqtar i vetëm. Shqyrtimi i çështjes ka vijuar në disa seanca gjyqësore, ku në seancën e gjashtë (të datës 2.10.2012), ndërsa paditësi ka kërkuar shtimin e kërimit të parë në objektin e padisë edhe me alternativën e kthimit të vlerës së sendit në rast pamundësie të kthimit të tij, përfaqësuesi i tyre krahas qëndrimit për këtë kërkesë, ka vërejtur se paditësi (subjekti i interesuar) nuk ka paguar taksën për aktet (tarifën gjyqësore). Në këtë rast gjykata ka urdhëruar paditësin (subjektin e interesuar) për rregullimin e kësaj të mete, për të cilën ai më datë 2.11.2012 ka marrë një akt garancie nga një bankë e nivelit të dytë për shumën 2.000 euro. Kërkesa për pagimin nga paditësi (subjekti i interesuar) të taksës për aktet është përsëritur nga kërkuesi Pëllumb Çela edhe në seancën e datës 24.4.2013, ndërkohë që në seancën e shtatëmbëdhjetë (të datës 4.7.2013) të paditurit (kërkuesit) kanë depozituar një kërkesë me shkrim për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes, në të cilën si shkak përjashtimi ata kanë parashtruar se gjyqtari ka vepruar në shkelje të ligjit në kushtet kur

ka vijuar shqyrtimin e padisë pa përcaktuar paditësi (subjekti i interesuar) vlerën e padisë dhe pa paguar ai taksën për aktet, duke u shkelur në këtë mënyrë atyre të drejtën për të kërkuar gjykimin e çështjes nga një trup gjykues i formuar nga tre gjyqtarë. Kjo kërkesë e të paditurve (kërkuesve) është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër i shkallës së parë, i cili, me vendimin e datës 9.9.2013, ka vendosur mospranimin e saj. Më tej, gjykimi i çështjes ka vijuar edhe përgjatë disa seancave të tjera gjyqësore, duke përfunduar gjykimi i saj nga trupi gjykues i formuar nga gjyqtari i vetëm.

31. Po ashtu, Gjykata çmon se në ankimin e paraqitur kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë, të paditurit (kërkuesit) kanë ngritur pretendime edhe për sa i përket formimit të trupit gjykues nga një gjyqtar i vetëm. Sipas tyre, çështja duhej të shqyrtohej me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë, sikundër ata kishin kërkuar, duke pasur parasysh se vlera e padisë, e përcaktuar paraprakisht nga paditësi (subjekti i interesuar), ka qenë në masën 161.207.540 lekë dhe në përfundim të gjykimit ka rezultuar gati dyfishi i saj, ndërkohë që kërkesa e tyre për formimin e trupit gjykues nuk është shqyrtuar dhe as është marrë parasysh. Ky pretendim i të paditurve (kërkuesve) është shqyrtuar nga gjykata e apelit, e cila e ka gjetur atë të pabazuar, duke arsyetuar se nuk rezulton e provuar që kjo palë të ketë kërkuar që çështja të gjykohej me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, referuar vlerës së padisë (*shih paragrafin 78 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

32. Gjithashtu, Gjykata konstaton se pretendimin në lidhje me formimin e trupit gjykues në gjykimin e çështjes në shkallë të parë të paditurit (kërkuesit) e kanë ngritur edhe në rekurs, për të cilin Gjykata e Lartë, në kuadër të shqyrtimit seleksionues, ka arritur në përfundimin se nuk përmbushte kriteret e parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

33. Nga sa më lart, Gjykata vëren se, pavarësisht se vlera e padisë e përcaktuar nga paditësi (subjekti i interesuar) ka qenë mbi 20 milionë lekë (konkretisht 161.207.540 lekë), kërkuesit nuk kanë kërkuar gjatë veprimeve përgatitore që çështja të gjykohej nga një trup gjykues i formuar nga tre gjyqtarë, ndërkohë që ligji procedural civil i kohës e ka kushtëzuar përcaktimin e formimit të trupit gjykues vetëm në këtë fazë të gjykimit të çështjes. Një kërkesë e tillë nga kërkuesit është bërë vetëm gjatë shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, duke u artikuluar ajo në



formën e një pretendimi për shkeljen e së drejtës në rastin e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit të depozituar më datë 4.7.2013.

34. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se kërkuessit i kanë pasur të gjitha mundësitë procedurale për të ushtruar të drejtën për të kërkuar gjykimin e çështjes me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë, të drejtë të cilën nuk e kanë ushtruar në momentin e duhur procedural. Për rrjedhojë, në kontekst të rrethanave të rastit konkret, Gjykata çmon se gjykimi i çështjes në shkallë të parë nga një trup gjykues i formuar me një gjyqtar nuk përbën për kërkuessit cenim të së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, ndaj ky pretendim është i pabazuar.

A.2 Për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme

35. Kërkuessit kanë pretenduar se gjyqtari i çështjes në shkallë të parë ka treguar njëanshmëri, pasi në mënyrë të qëllimshme nuk ka pasqyruar kërkesën e të paditurve për gjykimin e çështjes me trup gjykues të formuar nga tre gjyqtarë dhe ka lejuar gjykimin e saj pa paguar paditësi taksën gjyqësore sipas vlerës së objektit të padisë. Megjithatë pretendimet për njëanshmëri janë parashtruar në ankim, gjykata e apelit ka arsyetuar në mënyrë të gabuar se nuk provohej njëanshmëria. Ndërkohë, Gjykata e Lartë, si gjykatë ligji, duhej ta kishte marrë në analizë këtë pretendim dhe jo të mbyllte çështjen me mospranimin e rekursit.

36. Për këtë pretendim subjekti i interesuar Arjan Avllaj ka prapësuar se cenimi i parimit të paanshmërisë gjatë gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është tërësisht i pabazuar në ligj. Edhe Gjykata e Apelit Tiranë arriti në përfundimin se pretendimi nuk qëndronte.

37. Gjykata ka vlerësuar se gjykata e paanshme nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste, *testin subjektiv*, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, *testin objektiv*, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshëm në këtë drejtim. Kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues, këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshëm. Dyshimi

i mundshëm për paanshinë e gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr. 10, datë 12.4.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se kërkuessit kanë paraqitur tri kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit që gjykonte çështjen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku dy të parat nuk janë pranuar, ndërsa për kërkesën e tretë është vendosur pushimi i shqyrtimit. Në kërkesën e parë, depozituar më datë 4.7.2013, sikurse u parashtrua edhe më lart, përjashtimi i gjyqtarit të çështjes nga kërkuessit është kërkuar për shkakun se ai ka vepruar në shkelje të ligjit, ndërsa ka vijuar shqyrtimin e padisë pa përcaktuar paditësi (subjekti i interesuar) vlerën e padisë dhe pa paguar taksën për aktet, çka u ka shkelur atyre të drejtën për të kërkuar gjykimin e çështjes nga një trup gjykues i formuar nga tre gjyqtarë. Kjo kërkesë e të paditurve (kërkuessve) është shqyrtuar nga një gjyqtar tjetër i shkallës së parë, i cili, me vendimin e datës 9.9.2013, ka vendosur mospranimin e saj. Gjykata konstaton më tej se vendimet e marra në lidhje me kërkesat për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes, përfshirë edhe atë për kërkesën e parë, janë ankimuar nga kërkuessit bashkë me vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë. Pretendimet e ngritura në këtë rast janë shqyrtuar nga gjykata e apelit, e cila ka arritur në përfundimin se pala ankimuese (kërkuessit) nuk ka arritur të argumentojë bazueshmërinë e kërkesave në ndonjë nga rastet e parashikuara nga neni 72 i KPC-së, në mënyrë të tillë që të detyronte ligjërisht gjykatën për të vendosur pranimin e tyre (*shih paragrafin 77 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Po ashtu, Gjykata konstaton se pretendimet për njëanshmërinë e gjyqtarit të çështjes në shkallë të parë, referuar shkakut të ngritur në kërkesën e parë për përjashtimin e tij, kërkuessit i kanë ngritur edhe në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, e cila, në kuadër të shqyrtimit seleksionues, ka arritur në përfundimin se ai nuk përmbushte kriteret e parashikuara nga neni 472 i KPC-së.

39. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim kërkuessit pretendimin për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, në thelb, e kanë lidhur me veprimtarinë procedurale të gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë, e cila ka sjellë si pasojë shkeljen e së drejtës së tyre për t'u



gjykuar me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, pretendim të cilin Gjykata më sipër e gjeti të pabazuar. Në rrethanat kur këto pretendime janë të ndërrarura me njëra-tjetrën, Gjykata vlerëson se edhe argumentet e parashtruara nga kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e paanshme janë të pabazuara.

A.3 Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

40. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së aksesit dhe të ankimit efektiv, sepse Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhet të jepte përgjigje për pretendimet e ngritura në rekurs, për zbatimin e gabuar të ligjit material dhe procedural nga gjykatat më të ulëta, të cilat nuk i kishin mbështetur vendimet e tyre në prova.

41. Subjekti i interesuar Arjan Avllaj ka prapësuar se pretendimi për cenimin e së drejtës së aksesit dhe ankimit efektiv në gjykatë është i pabazuar, pasi vendimi i marrë nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit është në respektim të së drejtës për proces të rregullt ligjor.

42. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila duhet të dëgjojë pretendimet e tyre dhe të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 10, datë 12.4.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 32, datë 3.11.2022; nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'u drejtuar gjykatës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 6, datë 22.2.2022; nr. 22, datë 29.4.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

43. Sipas Gjykatës, e drejta për proces të rregullt ligjor përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.9.2022; nr. 67, datë 10.11.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjykata ka vlerësuar se veprimtaria seleksionuese e dhomës së këshillimit të Gjykatës së Lartë është një veprimtari e domosdoshme në funksion të aksesit në gjykatë vetëm të atyre çështjeve që i parashikon ligji, duke lënë jashtë përzgjedhjes kërkesat e paarsyeshme dhe haptazi të pambështetura në ligj. Sipas këtyre standardeve, faza e shqyrtimit paraprak është procedurë e cila zhvillohet gjithnjë në dhomën e këshillimit dhe kompetencat e Kolegjit të Gjykatës së Lartë ushtrohen *de plano*, pasi lidhen me seleksionimin e rekurseve që plotësojnë kriteret ligjore, ndërsa për rekursin që nuk plotësojnë kriteret e nenit 472 vendoset mospranimi i tyre bazuar në nenin 480 të KPC-së. Shqyrtimi paraprak vlerësues është kompetencë vetëm e trupës së gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se vendimet e Gjykatës së Lartë për mospranimin e rekursit mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimin të rekursit nga ana e kolegjeve të Gjykatës së Lartë gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

46. Gjykata vëren se, sikurse më lart u parashtrua, procesi gjyqësor ka nisur për padinë e subjektit të interesuar Arjan Avllaj, duke kërkuar nga kërkuesit kthimin e sendeve (8 njësi individuale të objektit ndërtimor, vendparkime, zyra dhe apartamente) ose vlerën e tyre, si dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm dhe vonesa në dorëzimin e tyre. Paditësit i është bashkuar dhe "Ani" sh.p.k., përmes një kërkesë për ndërhyrje kryesore. Si bazë ligjore e padisë janë përcaktuar nenet 296 e vijues të Kodit Civil (KC), që rregullojnë institutin e mbrojtjes së pronësisë, sikundër edhe nenet 456, 463, 476 dhe 481 të këtij kodi, që janë pjesë e dispozitave që rregullojnë institutin e detyrimeve. Po ashtu, janë përcaktuar edhe nenet 608 e vijues dhe 640 e vijues të KC-së, që rregullojnë institutin e detyrimeve që rrjedhin nga shkaktimi i dëmit dhe atë të shpërblimit të dëmit. Së fundi, është përcaktuar edhe neni 693 i KC-së, që është pjesë e dispozitave që rregullojnë institutin e kontratave në përgjithësi. Paditësi ka



pretenduar se sipas marrëveshjeve mes palëve ka qenë investitor për ndërtimin e objektit nga sipërmarrësi “Çela-X” sh.p.k., por se nuk ka marrë përfitimet që i takonin në raport me masën e investimit dhe që konsistojnë në sipërfaqet ndërtimore objekt padie ose vlerën e tyre në të holla, sipërfaqe këto që mbaheshin nga i padituri Pëllumb Çela dhe persona të tjerë mbi bazën e kontratave të lidhura nga sipërmarrësi, ndërkohë që nga mosdorëzimi dhe përdorimi i paligjshëm i sendeve i është shkaktuar dëm pasuror.

47. Po ashtu, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë e ka pranuar padinë pjesërisht. Ajo ka arsyetuar se pala paditëse nuk legjitimohet në kuadër të padisë së rivendikimit sipas nenit 296 të KC-së, pasi nuk është pronare e vetme e sendeve objekt padie, por bashkëpronare me palën e paditur. Nga ana tjetër, sipas saj, pala paditëse legjitimohej në kërkimet e saj në kuadrin e përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, pasi marrëdhënia juridike mes palëve është e natyrës kontraktore sipas marrëveshjeve të lidhura me tyre, ku referuar të cilave pala paditëse rezultonte investitori kryesor në ndërtimin e objektit, duke pasur të drejtën e fitimit në raport me investimin e bërë ose kompensimin e këtij fitimi me sipërfaqe ndërtimore. Pala e paditur ka marrë përfitime disa herë më të mëdha nga fitimi që i takonte sipas marrëveshjeve mes palëve, ndaj sendet objekt padie i përkasin palës paditëse si pjesë e fitimit të saj nga investimi, duke pasur pala e paditur detyrimin për kthimin e sendeve objekt padie që posedoheshin prej saj mbi bazë të kontratave absolutisht të pavlefshme, si dhe për pagimin e vlerës së sendeve objekt padie që posedoheshin nga të tretët në bazë të kontratave të shitjes me sipërmarrësin, si edhe detyrimin për pagimin e të ardhurave të nxjerra nga dhënia me qira e një prej sendeve objekt padie të poseduar nga ajo.

48. Gjykata vëren, gjithashtu, se gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke mos e pranuar ankimin e të paditurit. Ajo ka arsyetuar se shkaku juridik i padisë qëndron tek e drejta subjektive e pronësisë, e pretenduar nga paditësi se rrjedh nga cilësia si investitor ekskluziv i objektit të ndërtuar nga sipërmarrësi “Çela-X” sh.p.k., por e mohuar nga ky i fundit, pasi nuk ka marrë përfitimet që i takonin në raport me masën e financimit të kryer, që konsistojnë në sipërfaqet ndërtimore në natyrë ose vlerën e tyre në të holla (*shih paragrafin 47 të vendimit të gjykatës së apelit*). Sipas

gjykatës, referuar fakteve të provuara në gjykim, është i drejtë përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se marrëdhënia juridike e krijuar nga marrëveshjet e investimit (duke filluar nga ajo e datës 30.12.2022 dhe deri në atë të datës 23.2.2006) është ajo ku paditësi është në rolin e porositësit dhe të investitorit, për rrjedhojë i takon pronësia e produktit/veprës, ndërsa i padituri është në rolin e sipërmarrësit në ndërtim, pra i ofruesit të shërbimit të kryerjes së pavarur të punimeve kundrejt shpërblimit, rregulluar nga nenet 850-852 të KC-së (*shih paragrafin 55 të vendimit të gjykatës së apelit*). Sipas saj, kërkitimi i palës paditëse e ka bazën tek e drejta për të kërkuar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata, duke qenë pikërisht ajo mënyra e fitimit të pronësisë së sendeve objekt padie dhe jo regjistrimi i tyre në regjistrat e pasurive të paluajtshme, regjistrim ky që ka efekt deklarativ, por nuk përbën fakt juridik konstituiv (*shih paragrafët 68-69 të vendimit të gjykatës së apelit*).

49. Për sa i përket faktit të kontestuar nga i padituri në lidhje me investimin e bërë nga paditësi, gjykata e apelit e ka pranuar një fakt të tillë, duke e arsyetuar atë mbi të dhënat e sjella nga provat shkresore dhe ekspertimi kontabël, sikundër edhe nga dëshmitë e marra gjatë procesit penal kundër kërkuarit Pëllumb Çela, ku ai është deklaruar i pafajshëm me vendimin nr. 311, datë 29.2.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si edhe në përfundimet e arritura në vendimin penal të fajësisë së të dy kërkuarëve për veprën penale “Falsifikimi i dokumenteve” (*shih paragrafët 56-61 të vendimit nr. 1271, datë 3.7.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë*).

50. Gjykata e apelit ka pranuar se paditësi (subjekti i interesuar) Arjan Avllaj, si person fizik dhe ndërhyrësi kryesor (subjekti i interesuar) “Ani” sh.p.k. kanë vepruar si shoqëri e thjeshtë, në kuptim të nenit 1074 të KC-së, për kryerjen e investimit, me qëllim ndarjen e fitimeve, ndërsa ky i fundit, në disa furnizime të veçanta del si furnizues i materialeve të ndërtimit, përveçse ka realizuar edhe derdhje të kontributeve në para në arkën e përbashkët të investimit, ku mbi këtë bazë ka arritur në përfundimin se të dy bashkëpaditësit legjitimohen aktivisht në ngritjen e padisë (*shih paragrafët 62-67 të vendimit të gjykatës së apelit*). Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka pranuar se të dy të paditurit (kërkuarët), Pëllumb Çela dhe “Çela-X” sh.p.k., legjitimohen pasivisht, duke arsyetuar se posedues të sendeve dhe të detyruar nga kontrata, referuar rrethanave të



çështjes, rezultojnë që të dy ata (*shih paragrafin 71 të vendimit të gjykatës së apelit*).

51. Në lidhje me disponimet e gjykatës së shkallës së parë, gjykata e apelit i ka gjetur ato në përputhje me kërkimet e padisë, duke arsyetuar se për sa i përket disponimit të dytë të saj, vërtet vlerat e sendeve për të cilat janë detyruar të paditurit të paguajnë nuk korrespondojnë me ato të përshkruara në kontratat përkatëse me të tretët, por këto vlera kuptohet qartë se përbëjnë vlerat e tregut në momentin e zhvillimit të gjykimit referuar aktit të ekspertimit vlerësues. Në këtë kuptim, gjykata e shkallës së parë, në vend që të dispononte për kthimin e shumave sipas kontratave të lidhura vite më parë, sikundër edhe për shpërblimin e dëmit mbi këto shuma, e ka integruar këtë të fundit në shumat për të cilat i padituri detyrohet t'i kthejë paditësit, duke përfaqësuar ato, në këtë mënyrë, kthimin paditësit të asaj që i takon në bazë të kontratës, përfshirë edhe shpërblimin e dëmit nga vonesa në përmbushjen e detyrimit, çka është plotësisht e bazuar në nenin 476 të KC-së (*shih paragrafët 73–76 të vendimit të gjykatës së apelit*).

52. Së fundi, Gjikata vëren se Gjykata e Lartë (kolegji seleksionues) ka vendosur mospranimin e rekursit të të paditurve (kërkuesve), me arsyetimin se ai nuk përmbush kriteret e parashikuara nga ligji, pasi nuk përmban asnjë prej rasteve të përcaktuara nga neni 472 i KPC-së.

53. Gjykata vëren se Gjykata e Lartë ka listuar në pjesën hyrëse të vendimit shkaqet e rekursit të kërkuesit, të cilat në mënyrë të përmbledhur janë në drejtim të shkeljeve procedurale, zbatimit të gabuar të ligjit gjatë gjykimit nga gjykatat më të ulëta, paraqitjes së provave për kërkimin për kthimin e sendit e shpërblimin e dëmit, përbërjes së trupit gjykues gjatë gjykimit në shkallë të parë, krijimit të ndërgjyqësisë dhe arsyetimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë (*shih faqet 3–7 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me arsyetim të kufizuar, ka vlerësuar se shkaqet e rekursit nuk përmbushnin kriteret ligjore, pasi nuk përmbanin asnjë prej rasteve të nenit 472 të KPC-së. Kjo mënyrë arsyetimi është tashmë e konsoliduar në praktikën e Gjykatës së Lartë, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit gjatë shqyrtimit të tij paraprak në dhomën e këshillimit. Prandaj, Gjykata arrin në përfundimin se edhe në rastin në shqyrtim vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk ka cenuar të drejtën e aksesit

në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, për rrjedhojë pretendimi është i pabazuar.

A.4 Për gjykimin e drejtë të lidhur me parimin e sigurisë juridike

54. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e parimit të sigurisë juridike, pasi gjykatat duke vendosur pranimin e padisë së rivendikimit të paraqitur nga subjekti i interesuar Arjan Avllaj i kanë mohuar të drejtën e pronësisë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Apelit Tiranë kanë zbatuar gabim ligjin duke arsyetuar se ekziston legjitimitimi pasiv i kërkuesit në kërkimet e paraqitura në kërkesëpadi, kanë interpretuar në mënyrë të gabuar ligjin dhe aktmarrëveshjet e lidhura mes palëve.

55. Subjekti i interesuar Arjan Avllaj ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike nuk qëndron, pasi shoqëria “ÇELA-X” sh.p.k. nuk ka pasur titull pronësie të regjistruar. Gjykatat kanë hetuar dhe arritur në përfundimin se shoqëria ka pasur cilësinë e ndërtuesit sipërmarrës, duke arsyetuar në mënyrë të plotë edhe në lidhje me ndërgjyqësinë. Pra, u ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të kërkuesve.

56. Gjykata vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9577, datë 6.10.2014, në mënyrë të përmbledhur, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë, të bashkuar me kërtime të njëjta me ndërhyrësin kryesor, shoqërinë “ANI” sh.p.k., duke detyruar kërkuesit të dorëzojnë në natyrë ambientet që posedoheshin prej tyre në bazë të kontratave të shitjes absolutisht të pavlefshme dhe pagimin e vlerës së ambienteve të tjera të kërkuara, por që në bazë të kontratave të sipërmarrjes posedoheshin nga të tretët (dhe nëse subjekti i interesuar Arjan Avllaj kërkon gjyqësisht pavlefshmërinë juridike të kontratave të lidhura mes kërkuesit dhe personave të tretë), pranimin e padisë të ndërhyrësit kryesor shoqërisë “Alba Ceramica N” sh.p.k. dhe rrëzimin e pjesëve të tjera të kërkesëpadiës. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka arsyetuar se subjekti i interesuar, paditës në atë gjykim, legjitimohej në kërkimet e tij në kuadër të përmbushjes së detyrimeve kontraktuale, detyrime që parashikoheshin në aktmarrëveshjet e lidhura mes palëve (*shih paragrafin 1, pjesa e titulluar “Shkaqet e pranimit” të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë*).

57. Pas ankimit të kërkuesve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 433, datë 16.10.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 9577, datë



6.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për sa i takon pranimit të padisë të subjektit të interesuar Arjan Avllaj dhe të shoqërisë “ANI” sh.p.k. (në cilësinë e ndërhyrësit kryesor), prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit të çështjes për sa i takon padisë së ndërhyrësit kryesor tjetër, shoqërisë “Alba Ceramica N” sh.p.k. Gjykata e Apelit Tiranë ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në prova e në ligj, duke arritur në përfundimin se marrëdhënia juridike është krijuar me aktmarrëveshje, sipas së cilës subjekti i interesuar ka qenë porositës dhe investitor, e për rrjedhojë i takon pronësia e produktit/veprës, ndërsa kërkuessit kanë qenë sipërmarrës të ndërtimit, pra ofrues të shërbimit të kryer kundrejt shpërbllimit (*shih paragrafin 55 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Në vijim, sikurse u analizua, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuessve.

58. Gjykata ka pohuar se parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin. Në rastin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, siguria juridike nënkupton që kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Kur vendimi ka marrë formë të prerë, ai është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 10, datë 13.2.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Gjykata ka pohuar në mënyrë konstante se është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të vlerësojnë faktet dhe provat e administruara, si dhe të interpretojnë ligjin për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.5.2023; nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 3, datë 23.2.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ajo ndërhyr atëherë kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose është i tillë që

gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë standardet e mësipërme kushtetuese në raport me faktet e çështjes në shqyrtim, vlerëson se, në thelb, pretendimi i kërkuessve për cenimin e parimit të sigurisë juridike ka të bëjë me interpretimin e ligjit nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në raport me fakte të veçuara pjesë të mosmarrëveshjes, interpretim ky që nuk duket të jetë haptazi i paarsyeshëm ose arbitrar, i tillë që e bën të padrejtë gjykimin. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi është i pabazuar.

61. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi, është i pabazuar, ndaj dhe kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 6.12.2023.

Shpallur, më 11.1.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Sandër Beci, Marjana Semini, Gentë Ibrahimi



VENDIM
Nr. 6, datë 12.1.2024

PËR SHPALLJEN E
MOSZGJEDHSHMËRISË SË
KANDIDATIT TË RADHËS NË LISTËN
SHUMEMËRORE TË PARTISË
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU
TIRANË, ZNJ. DALLËNDYSHE AGIM
BICI, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS
SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I
SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe në kërret II, pika 3, dhe V të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 43 prot., datë 8.1.2024, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e mungesës pa arsye për mbi 6 (gjashtë) muaj rresht në Kuvend, të deputetit z. Arben Nevruz Ahmetaj, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se, në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve merr vendim për dhënien e mandatit të deputetit, kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67, të Kodit Zgjedhor.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e

Shqipërisë, me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator, me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr. 409, datë 23.6.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datë 25.4.2021, dhe miratoi listën shumemërore të deputetëve të zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Tiranë. Sipas vendimit të sipërcituar, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021 ka fituar 18 (tetëmbëdhjetë) mandate.

Rezulton se lista shumemërore e subjektit zgjedhor Partia Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Në këto kushte, zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor me kandidatin e radhës.

Sipas listës shumemërore të kandidatëve për deputet për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, miratuar me vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 409, datë 23.6.2021, rezulton se kandidati, të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 21 (njëzet e një) znj. Dallëndyshe Agim Bici.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të pikës 3 të kreut II të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 43/1 prot., datë 9.1.2024, i është drejtuar znj. Dallëndyshe Agim Bici, duke e njoftuar për depozitimin në KQZ të formularit të vetëdeklarimit për garantimin e integritetit të kandidatit.

Referuar pikës 3 të kreut II të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, afati për depozitimin në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të formularit të vetëdeklarimit është 10 ditë.

Me shkresën nr. 5111 prot., datë 11.1.2024, kandidati për deputet znj. Dallëndyshe Agim Bici njoftoi Komisionin Qendror të Zgjedhjeve se nuk do të vijojë me procedurat ligjore përkatëse për marrjen e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.



Referuar nenit 5, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, refuzimi për të dorëzuar formularin e vetëdeklarimit ose mosparaqitja e formularit përbën shkak për mosregjistrimin apo moszgjedhshmërinë e kandidatit si deputet i Kuvendit. Gjithashtu, referuar kreut II, pika 3 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëse subjekti nuk depoziton formularin e vetëdeklarimit brenda afatit, konsiderohet se refuzon propozimin e organit kompetent për kandidim, zgjedhje, apo emërim. Në këtë rast, organi kompetent ndërpret procedurën për propozimin e këtij subjekti për t'u kandiduar, zgjedhur apo emëruar në atë funksion publik.

Referuar nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 138/2015, konstatohet se kandidati i radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për qarkun Tiranë, nuk do të vijojë me procedurat ligjore përkatëse për marrjen e mandatit të deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2 dhe 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe në krerët II, pika 3, dhe V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOS:

1. Të shpallë moszgjedhshmërinë si deputet në Kuvendin e Shqipërisë të kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, qarku Tiranë, znj. Dallëndyshe Agim Bici.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

VENDIM Nr. 7, datë 15.1.2024

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË, QARKU TIRANË, Z. PLARENT PJETËR NDRECA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 43 prot., datë 8.1.2024, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e mungesës pa arsye për mbi 6 muaj rresht në Kuvend, të deputetit z. Arben Nevruz Ahmetaj, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për



Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, ka fituar 18 (tetëmbëdhjetë) mandate.

Rezultoni se lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67, të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezultoni se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 22 (njëzet e dy), z. Plarent Pjetër Ndreca.

Me shkresën nr. 92 prot, datë 12.1.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Plarent Pjetër Ndreca, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave, në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Plarent Pjetër Ndreca ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër TR-PS-38601/1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b”, dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka kërkuar informacion nga Zyra e Gjendjes Civile, si dhe nga Zyra e Gjendjes

Gjyqësore, për z. Plarent Pjetër Ndreca, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Plarent Pjetër Ndreca.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, nëpërmjet komunikimit në rrugë elektronike, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Plarent Pjetër Ndreca, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, konstatohet se të dhënat e kandidati për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Plarent Pjetër Ndreca, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidati në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Arben Nevruz Ahmetaj, i përket kandidati vijues në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë i renditur me numër rendor 22 (njëzet e dy), z. Plarent Pjetër Ndreca.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe në kreun V, të vendimit të Kuvendit, nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidati të radhës në



listën shumëmbrore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Plarent Pjetër Ndreca.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e tij.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONERI SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

VENDIM
Nr. 9, datë 23.1.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “G.S.K”
SHPK NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “P”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 67/2 prot., datë 18.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘G.S.K’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 67 prot., datë 10.1.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e

licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.4); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “G.S.K” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si vijon në zbatim të nenit 9 të rregullores, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a” dhe “c” dhe për pikën 2.4, germat “a”, “b” dhe “d”. Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penalitetit) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë në formatin origjinal/fotokopje të njëzuar me origjinalin strukturën organizative të saj dhe gjithashtu të depozitojë në ERE informacion mbi stafin teknik të kësaj strukture që do të angazhohet me veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat e saktësuara të vitit 2020 dhe të përcjellë në format origjinal/fotokopje të njëzuar me origjinalin pasqyrat financiare për vitin 2021. Gjithashtu, shoqëria duhet të dokumentojë/depozitojë në ERE kontratën e huas/kontratën e kredisë, sikurse parashikuar në planin e biznesit, për të mbuluar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën një muaj.

Pika 2.4 Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike;

- germa “c”: shoqëria duhet të depozitojë në formatin origjinal ose fotokopje të njëzuar me origjinalin kontratën e qirasë për disponimin e ambientit për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit të



energjisë elektrike. Po ashtu, duke qenë se afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, do të saktësohet me shoqërinë, nëse ky do të jetë dokument i përkohshëm që shërben vetëm për momentin e aplikimit deri në përfundim të afatit të kontratës apo do të sjellë një kontratë qiraje që do të mbulojë të gjithë periudhën 5-vjeçare të licencimit.

- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 10, datë 23.1.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “G.S.K” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 67/3 prot., datë 18.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘G.S.K’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “G.S.K” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 67 prot., datë 10.1.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

· Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin,



transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “G.S.K” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germa “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germa “a” dhe “d”; për pikën 1.3, germa “a” dhe “c” dhe pikën 2.5. Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

- *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- *germa “b”*: aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penaltetit) për vetë shoqërinë dhe administratorin e saj.

- *germa “c”*: shoqëria duhet të përcjellë në formatin origjinal/fotokopje të njësuar me origjinalin strukturën organizative të saj dhe të depozitojë informacion se cili është stafi teknik që do të angazhohet në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

- *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- *germa “b”*: shoqëria duhet të depozitojë pasqyrat financiare të saktësuara të vitit 2020 dhe të përcjellë në format origjinal/fotokopje të njësuar me origjinalin pasqyrat financiare për vitin 2021. Gjithashtu, duhet të depozitojë kontratën e huas/kontratën e kredisë, sikurse parashikuar në planin e biznesit, për të mbuluar ushtrimin e veprimtarisë për të paktën një muaj.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të

ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 14, datë 27.1.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “TPLANI HC” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALI “VALBONA”, NË LUMIN E VALBONËS, BASHKIA TROPOJË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2300 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 99/3 prot., datë 25.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali ‘Valbona’, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw”, konstatoi se:

- Shoqëria “TPLANI HC” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 99, datë 13.1.2022, ka paraqitur aplikimin për pajisjen me licencë për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentrali



“Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw.

- Me e-maillet e dërguara dhe të protokolluara në ERE me nr. 99/1 prot., datë 19.1.2022 dhe nr. 99/2 prot., datë 19.1.2022, shoqëria ka depozituar dhe dokumente shtesë në kuadër të këtij aplikimi.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “TPLANI HC” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin si në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, germen “c” dhe për pikën 2, gerrat “b”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni, si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- *germa “b”*: aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore për vetë shoqërinë “TPLANI HC” sh.p.k.

- *germa “c”*: aplikuesi duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative, së bashku me stafin teknik që do të angazhohet për me prodhimin e energjisë elektrike.

Pika 1.3 Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- *germa “a”*: shoqëria duhet të depozitojë vërtetimet përkatëse për shlyerjen e detyrimeve.

- *germa “b”*: shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për vitet 2019–2021, si dhe pasqyrat paraprake të vitit 2022. Gjithashtu,

shoqëria duhet të depozitojë informacionin/ dokumentacionin përkatës në kuadër të zbatimit të nenit 11 të kontratës së koncesionit, ku përcaktohet procedura dhe afati për të kryer testimin e veprës.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- *germa “a”*: shoqëria duhet të plotësojë të dhënat në lidhje me llojin e HEC-it, numrin e njërive gjeneruese, vitin e ndërtimit dhe datën e fillimit të operimit.

- *germa “b”*: shoqëria duhet të informojë ERE-n në rast se ndryshimet e kuotave që kanë ndodhur në strukturën e shoqërisë përgjatë viteve kanë afektuar këtë kontratën e koncesionit të nënshkruar me METE-n.

- *germa “c”*: shoqëria duhet të sqarojë/saktësojë përse kërkesa për pikën e lidhjes është bërë për kapacitetin e instaluar 2100 kw, ndërkohë që në kontratën e koncesionit fuqia e instaluar është 2300 kw; duhet të sqarojë pse kërkesa dhe më pas miratimi i pikës së lidhjes është bërë për koncesionarin; të bëjë me dije nëse pika e lidhjes ka ndryshuar.

- *germa “d”*: shoqëria duhet të sqarojë statusin e lejes për përdorimin e burimit ujor përkatës për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC Valbona.

- Kontrata e koncesionit nr. 279 rep., nr. 38 kol., datë 29.1.2009, ka një afat 35-vjeçar, por sqarojmë se ERE në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, nuk mund të japë një licencë me afat më të madh se 30 vjet për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Sa konstatohet nga llogaritja e afateve, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës së koncesionit sipërcituar, rezulton se shoqëria ka humbur afërsisht 14 vjet nga periudha koncesionare dhe periudha e mbetur për licencim është 16 vjet. Gjithsesi, në rast licencimi të shoqërisë, në fazën përfundimtare do të bëhet përlllogaritja e afateve që i mbeten nga periudha koncesionare.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “TPLANI HC” sh.p.k. në veprimtarinë e



prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Valbona”, në lumin e Valbonës, Bashkia Tropojë, me kapacitet të instaluar 2300 kw, për një afat 16-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 15, datë 27.1.2023

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË
“BALKAN ENERGY TRADE” SHPK PËR
LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s; në mbledhjen e tij të datës 27.1.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 82/3 prot., datë 26.1.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Balkan Energy Trade’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 341, datë 21.12.2022 ka vendosur të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 23.12.2022 dhe 24.12.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 1.1.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 2015/3 prot., datë 30.12.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 82 prot., datë 11.1.2023, nr. 82/1 prot., datë 20.1.2023, dhe 82/3 prot., datë 25.1.2023.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në zbatim të aneksi A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Balkan Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.

- Nga vlerësimi i këtij aplikimi rezulton se nuk është depozituar ende vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit) për administratorin e shoqërisë, por është dokumentuar aplikimi përkatës për marrjen e këtij vërtetimi.



- Duke qenë se ky vërtetimi lëshohet nga një organ tjetër dhe në zbatim të nenit 66, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet të pezullohet vendimarrja e Bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike deri në 10 (dhjetë) ditë-punë nga marrja dijeni e vendimit.

- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pezullojë vendimarrjen Bordit të ERE-s në lidhje me licencimin e shoqërisë “Balkan Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike deri në 10 (dhjetë) ditë-punë nga marrja dijeni e vendimit.

2. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 135, datë 11.4.2023

MBI MIRATIMIN E AMENDIMIT NR. 2 TË KONTRATËS “PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E TRANSMETIMIT NDËRMJET OST SHA DHE KESH SHA”

Në zbatim të neneve 16, 20, germa “h”, 47, 56, germa “f”, 62 dhe 90 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pjesës I,

nenit 4, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM-së nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 584, datë 8.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1111/1 prot., datë 7.4.2023, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi amendimin nr. 2 të kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.”, konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 30, datë 16.2.2023 miratoi amendimin nr. 1 të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit” ndërmjet Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230, datë 12.9.2022.

- Palët, nëpërmjet shkresës së përbashkët nr. 1691/1 prot., të OST sh.a. dhe nr. 1668/1 prot., të KESH sh.a., datë 23.3.2023, protokolluar në ERE me nr. 1111 prot., datë 23.3.2023, kanë përcjellë amendimin nr. 2 të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit” ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a., i cili gjendet gjithashtu i publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, në rubrikën “Konsultime”.

- Nga shqyrtimi i kontratës të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 230/2022 dhe amendimit nr. 2 të kësaj kontrate vihen re këto ndryshime:

- Neni 1 i amendimit nr. 2 të kontratës së paraqitur për miratim, amendon nenin 3 (Të drejtat dhe detyrimet e blerësit) të kontratës së miratuar me vendimin nr. 230, datë 12.9.2022, (ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 30, datë 16.2.2023).



- *Neni 2 i amendimit nr. 2 të kontratës së paraqitur për miratim*, amendon nenin 7 (dorëzimi, matja, transmetimi dhe risku) të kontratës së miratuar me vendimin nr. 230, datë 12.9.2022 (ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 30, datë 16.2.2023).

- *Neni 3 i amendimit nr. 2 të kontratës së paraqitur për miratim*, amendon nenin 11 (faturimi dhe pagesa) të kontratës së miratuar me vendimin nr. 230, datë 12.9.2022, (ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 30, datë 16.2.2023).

- Rezulton një gabim material në numërim në amendimin nr. 2 të kontratës së paraqitur për miratim, pasi përsëritet dy herë në numërim neni 3, neni 3 i përsëritur (i cili duhet të ndryshohet sipas numërimit në neni 4) i amendimit nr. 2 të kontratës së paraqitur për miratim, si dhe nenet 4 dhe 5 duhet të ndryshohen përkatësisht në nenet 5 dhe 6.

- Duke marrë në konsideratë procesin e operimit të bursës ALPEX, amendimet e paraqitura nga palët, vlerësohet se do të mundësojnë që kjo kontratë të trajtohet si kontratë OTC (*Over the Counter Contracts*) në DAM që do të zhvillojë ALPEX, ku i jepet përparësi përputhjes së urdhërporosive të blerësit dhe shitësit. Si blerësi ashtu edhe shitësi do të krijojnë një portofol të dedikuar për zbatimin e detyrimeve të kontratës OTC në ALPEX DAM për të përmbushur vëllimet sipas kësaj kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e amendimit nr. 2 të kontratës “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a. (amendimi bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Amendimi nr. 2 i kontratës së nënshkruar nga palët “Për shitblerjen e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit ndërmjet OST sh.a. dhe KESH sh.a.” me korrigjimet përkatëse të dërgohen në ERE brenda 5 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

3. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëritë OST sh.a. dhe KESH sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data

e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 138, datë 14.4.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGY MARKET ALBANIA” SHPK NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 877/15 prot., datë 13.4.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 59, datë 24.2.2023 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 25.2.2023 dhe 26.2.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data



6.3.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e kësaj procedure u botua edhe në faqen zyrtare të ERE-s.

- Me qëllim shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 877/5 prot., datë 24.3.2023, dhe vijimin e korrespondencës së nevojshme, me vendimin e Bordit nr. 113, datë 27.3.2023, u vendos zgjatja deri në 20 (njëzet) ditë e afatit të vendimmarrjes së aplikimit të shoqërisë “Energy Market Albania” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit dhe dokumentacionit plotësues të aplikimit me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 877/10 prot., datë 31.3.2023, nr. 887/12 prot., datë 12.04.2023 dhe nr. 887/14 prot., datë 13.4.2023 rezulton se shoqëria “Energy Market Albania” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c” dhe pikën 2.5.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energy Market Albania” sh.p.k. në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 139, datë 14.4.2023

MBI MIRATIMIN E KUFIJVE MINIMALË DHE MAKSIMALË TË LEJUAR TË ÇMIMIT PËR TREGUN E DITËS NË AVANCË

Në zbatim të neneve 16, 18, pika 1, germa “a” dhe “dh”; 19, germa “a”; 57 dhe 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; pikës 3.5, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; “Rregullave të tregut të energjisë elektrike”, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 14.4.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1177/1 prot., datë 13.4.2023, të përgatitur nga grupi i punës “Mbi miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 347, datë 27.12.2022, vendosi të miratojë rregullat e tregut të energjisë elektrike (kushtet e përgjithshme, përkufizimet, procedura e tregimit, si dhe procedura e klerimit dhe shlyerjes) dhe me vendimin nr. 106, datë 23.3.2023, Bordi i ERE-s ka miratuar disa shtesa në rregullat e tregut të energjisë elektrike.

- Shoqëria “Alpex” sh.a., me shkresën nr. 106 prot., datë 31.3.2023, ka paraqitur një propozim për miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë (*maximum and minimum price threshold*), për operimin e jobashkimit të tregjeve, për të cilin “Alpex”-i i referohet si mundësi për kryerjen e një ankandi të



dytë, sipas përcaktimeve të procedurës së tregimit të rregullave të tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e ERE-s nr. 347/2022.

- *Kufiri maksimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë: + 900 €/MWh.*

- *Kufiri minimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë: 0 €/MWh.*

- Në zbatim të dispozitës B.2.3.1 të procedurës së tregimit të rregullave të tregut të energjisë elektrike, përcaktohet se: *“Procedura për një ankand të dytë mundësohet nga ‘Alpex’-i në rastet kur çmimi klerues i tregut që vjen si pasojë e zgjidhjes nëpërmjet algoritmit të bashkimit të tregjeve të ditës në avancë, është e barabartë me ose kalon kufirin minimal dhe maksimal të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë të përcaktuar për ankandin e dytë për një ose më shumë njësi kohore tregu për një ose më shumë zona ofertimi”.*

- Miratimi i këtyre kufijve nga ERE është në zbatim të shtojcës A, tabelës A.1 “Specifikimet e produkteve të segmentit të tregut të ditës në avancë” dhe është një mekanizëm i rëndësishëm, i cili mbron tregun e energjisë elektrike nga çmime të cilat çojnë në deformime të panevojshme për arsye se ky treg është ende i pamaturuar. Këta kufij do të shërbejnë për një periudhë tranzitore deri sa të vlerësohet se tregu i organizuar me shumicë i energjisë elektrike është stabilizuar.

- Ky propozim mbështetet në Metodologjinë e parashikuar në përputhje me nenin 41(1) të rregullores së Komisionit Evropian nr. 2015/1222, datë 24.7.2015, “Për alokimin e kapaciteteve dhe menaxhimin e kongjestioneve”, si dhe referuar praktikave të ndjekura nga bursat e energjisë të vendeve evropiane, për vendosjen e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë.

- Veç sa më sipër, meqenëse Bursa e Energjisë Elektrike momentalisht është funksionale vetëm në zonën e ofertimit në Shqipëri, këta kufij do të shërbejnë vetëm për këtë zonë dhe jo për bashkimin e tregjeve ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës. Në momentin që do të bëhet operacionale Bursa e Energjisë Elektrike për zonën e ofertimit të Kosovës dhe shoqëria ALPEX sh.a., do të vlerësojë se këta kufij do të jenë ende të nevojshëm, atëherë do të paraqesë për miratim kufijtë edhe për zonën e bashkimit të tregjeve të cilët do të jenë objekt i miratimit nga autoritetet rregullatore të të dyja vendeve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e kufijve minimalë dhe maksimalë të lejuar të çmimit për tregun e ditës në avancë për operimin e jobashkimit të tregjeve, si vijon:

- kufiri maksimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë: + 900 €/MWh;

- kufiri minimal i lejuar i çmimit për tregun e ditës në avancë: 0 €/MWh.

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike – Alpex sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe palët e tjera të interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 222, datë 10.7.2023

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN QERSHOR 2023 PËR KLIENTËT E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 kV

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë



17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.7.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1732/3 prot., datë 7.7.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin qershor 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 5024 prot., datë 30.6.2023, protokolluar me tonën me nr. 1732/2 prot., datë 3.7.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin qershor 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

- Referuar kërkesës së sipërcituar të FSHU sh.a., vihet re se shoqëria vijon të përfshijë ndër të në përllogaritjen e këtij çmimi kostot e disbalancave. ERE në mënyrë të përsëritur ka sqaruar shoqërinë se bazuar në nenin 6, pika 3 dhe pika 5 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, e ndryshuar, tarifa që FMF-ja do të aplikojë/ngarkojë te klientët, do të përfshijë kostot për blerjen e energjisë elektrike për këta klientë, për periudhën e lëvrimit. Mbi këtë tarifë do të aplikohet dhe një marzh i furnizimit, i cili vendoset nga Rregullatori. Sikurse përcaktuar në metodologji, kostot e imbalancave do të llogariten dhe faturohen në përputhje me përcaktimet e Rregullave të Tregut dhe akteve të tjera në fuqi.

- Mbështetur në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2023, janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.

- Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022, të Bordit të ERE-s, kostot administrative të përllogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 maj 2022–31 dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, është 0.85 lekë/kWh.

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, e ndryshuar, referuar aplikimit të FSHU sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin qershor 2023, përllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin qershor 2023</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	10.45
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.31
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA		Leke/kWh 14.22



- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *14.22 lekë/kWh për muajin qershor 2023*.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin qershor 2023, prej 14.22 lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 223, datë 10.7.2023

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
S NË LIDHJE ME TRANSFERIMIN E
PJESSHËM DHE MODIFIKIMIN E
PJESSHËM TË LICENCËS PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE, VETËM PËR HEC-in
ZALLI I BULQIZËS, NGA SHOQËRIA
“TEODORI 2003” SHPK TE SHOQËRIA
“KONCESIONARE TËRNOVË ZALL
BULQIZË” SHPK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat

Faqe | 2168

dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1202/34 prot, datë 6.7.2023, të drejtorive teknike të ERE-s “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin 161, datë 9.5.2023, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 4.11.2009, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. te shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k., vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, me kapacitet të instaluar 5.350 MW.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.5.2023 dhe 12.5.2023). Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palë të treta, janë paraqitur në ERE objeksione ndaj këtij vendimi, nga palët e interesuara.

- Në zbatim të nenit 10, pika 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, ERE me shkresën nr. 1202/28 prot., datë 21.6.2023, i dërgoi shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k. objeksionet si më sipër, duke i kërkuar të paraqesë shpjegimet përkatëse për secilin prej tyre.

- Me qëllim sqarimin e të gjitha objeksioneve dhe kërkesave të depozituara në lidhje me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 9.5.2023, u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua në ambientet e ERE-s më datë 3.7.2023, mes përfaqësuesve të ERE-s, Ministrisë së



Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k., shoqërisë “Teodori” sh.p.k., shoqërisë “Albania Hydro Investments Holding” sh.p.k., Bankës “OTP Albania Bank” sh.a. dhe znj. SH.N, aksionere e shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k..

- Për gjithë sa më sipër, për të analizuar të gjitha objeksionet, sqarimet e dhëna nga aplikuesi mbi këto objeksione, e po ashtu, me qëllim shqyrtimin e pretendimeve që palët paraqitën në këtë seancë apo depozitim të dokumentacionit në vijim të seancës së mbajtur, çka mund të sjellë nevojën e zhvillimit të një korrespondence të mëtejshme dhe/ose seance dëgjimore, vlerësojmë zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. të shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë por jo më shumë se 30 ditë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare të Bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in Zall i Bulqizës, nga shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. të shoqëria “Koncesionare Tërnovë Zall Bulqizë” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Teodori 2003” sh.p.k., shoqërinë “Teodori” sh.p.k., shoqërinë “Albania Hydro Investments Holding” sh.p.k., Bankën “OTP Albania Bank” sh.a. dhe palët e interesit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga

data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 224, datë 10.7.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 40, DATË 10.3.2022, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘LAJTHIZA INVEST’ SHA NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “QAMI 1”, ME KAPACITET TË INSTALUAR 1.730 mw”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 70/8 prot., datë 7.7.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 40, datë 10.3.2022, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Lajthiza Invest’ sh.a., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Qami 1’, me kapacitet të instaluar 1.730 mw”, i ndryshuar”,

konstatoi se:

• Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 40, datë 10.3.2022, i ndryshuar, me vendimin nr. 178, datë 18.5.2023, vendosi të licencojë shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 mw, për një afat



30-vjeçar, duke i lënë kushtin që të depozitojë në ERE lejen e përdorimit të burimit ujqor të rinovuar jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

• ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1397 prot., datë 26.5.2022, duke i njoftuar ndryshimin e vendimit si më sipër dhe duke i evidentuar detyrimin për të depozituar në ERE Lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor.

• Me shkresën e protokolluar në ERE nr. 1397/3 prot., datë 30.5.2023, shoqëria depozitoi lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor për prodhimin energjisë elektrike nga HEC “Qami 1”, me një afat 5-vjeçar, deri më 23.2.2028.

• Me depozitim të këtij dokumenti, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 40/2022, i ndryshuar, por duke qenë se kjo leje nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit dhe, po ashtu, i nënshtrohet rinovimit, vlerësohet që kjo pikë të ndryshojë, duke i lënë kushtin shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Qami 1” brenda datës 23.2.2028.

• Në nenin 53, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.*

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 40/2022, i ndryshuar, ndryshon dhe bëhet:

3. Shoqëria “Lajthiza Invest” sh.a. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjie nga HEC “Qami 1” brenda datës 23.2.2028.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Lajthiza Invest” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit

të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 229, datë 19.7.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB SUN ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1892/1 prot., datë 14.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Alb Sun Energy’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në Bashkinë Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Alb Sun Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1892 prot., datë 7.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike



nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Alb Sun Energy” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”, si dhe pikën 2.1, germat “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim, gjithashtu, rezulton se duhet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, “Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë”

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Germa “b”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (Dëshminë e penaltetit), lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për vetë shoqërinë “Alb Sun Energy” sh.p.k.

- Germa “c”: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative, ku të jetë përfshirë dhe stafi teknik, referuar veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”

Pika 2.1. Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- Germa “a”: shtojcën 2 të plotësuar.

- Germa “b”: kontratën përkatëse të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE-n) për ndërtimin dhe shfrytëzimin e centralit fotovoltaiik.

- Për dokumentacionin e plotësuar pjesërisht do të njoftohet aplikuesi që të bëjë plotësimin e tij, brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Sun Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Alb Sun Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 230, datë 19.7.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 2” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 mw (AC)

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa



“a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1888/1 prot., datë 14.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Erseka Solar Park 2’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw (AC), me vendndodhje në Bashkinë Kolonjë, qarku Korçë”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1888 prot., datë 5.7.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw (AC), me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3310, fshati Starje, Njësia Administrative Qendër Ersekë, Bashkia Kolonjë, qarku Korçë.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”, si dhe për pikën 2.1, germat “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim gjithashtu rezulton se duhet të plotësohet dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germa “a”: saktësimet përkatëse në numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetin e instaluar të secilës. Gjithashtu, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacion teknik mbështetës për deklaratën e saj për jetëgjatësinë e pritshme të centralit prej 35 vjetësh;

- germa “c”: miratimin përfundimtar të operatorit të rrjetit për lidhjen e centralit/centraleve me rrjetin elektrik.

- Për dokumentacionin e plotësuar pjesërisht do të njoftohet aplikuesi që të bëjë plotësimin e tij brenda afatit të përcaktuar nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 20 mw (AC).

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 2” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 231, datë 19.7.2023

**MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË
BORDIT TË ERE-s, NË LIDHJE ME
APLIKIMIN E SHOQËRISË “EU GREEN
ENERGY” SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të



ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1271/11 prot., datë 18.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘EU Green Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 195, datë 19.6.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.6.2023 dhe 21.6.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1271/8 prot., datë 23.6.2023, ERE i njoftoi shoqërisë vendimin nr. 195/2023 dhe dokumentacionin që nevojitet të plotësohet për këtë aplikim.

- Në datën 17.7.2023, shoqëria depozitoi në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga shoqëria në kuadër të plotësimit të dosjes së aplikimit dhe nevojës që mund të lindë për korrespondencë të mëtejshme pas shqyrtimit të tij, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k. për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e

shoqërisë “EU Green Energy” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “EU Green Energy” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 232, datë 19.7.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1756/6 prot., datë 14.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë ‘SPV Blue 1’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1756 prot., datë 7.6.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 197, datë 19.6.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.6.2023 dhe 21.6.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së



komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1757/4 prot., datë 23.6.2023, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e plotësuar pjesërisht të këtij aplikimi.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1757/5 prot., datë 4.7.2023 dhe nr. 1757/7 prot., datë 13.7.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gerrat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gerrat “a”, “b” dhe “c”; si dhe pikën 2.5.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM

Nr. 233, datë 19.7.2023

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “ç”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d”, si dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 57/9 prot., datë 14.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1757 prot., datë 7.6.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 196, datë 19.6.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.6.2023 dhe 21.6.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.6.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1757/4 prot., datë 23.6.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe dokumentacionin e plotësuar pjesërisht të këtij aplikimi.

- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1757/6 prot., datë 4.7.2023 dhe nr. 1757/8 prot.,



datë 13.7.2023, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të këtij aplikimi.

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s, pagesën e aplikimit në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. ka plotësuar tërësisht dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”, si dhe për pikën 2.4, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Për sa bërë me dije nga vetë shoqëria, se sistemi IT do të bëhet funksional, duke filluar nga data 1.4.2024, vlerësohet t’i lihet kusht që para fillimit të operimit, të njoftojë ERE-n për bërjen funksional të këtij sistemi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërisë “SPV Blue 1” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Para fillimit të operimit, shoqëria “SPV Blue 1” sh.p.k. të njoftojë ERE-n për bërjen funksional të sistemit IT.

3. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 234, datë 19.7.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “HYDRO SETA” SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1890/1 prot., datë 14.7.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Hydro Seta’ sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1890 prot., datë 7.7.2023, paraqiti kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 5, datë 17.1.2019, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 18.1.2024

- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 433, seria T19, është 17.1.2024).

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe



heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikanti duhet të depozitojë në ERE: formatin e plotësuar të aplikimit, sipas shtojcës 1; çdo modifikim ose ndryshim të mundshëm të dokumentacionit të të dhënave teknike apo dokumentacionit tjetër të depozituar në aplikimin për pajisje me licencë; informacion mbi ushtrimin e veprimtarisë e licencuar (kontrata për shitblerjen e energjisë, nëse ka pasur).

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Hydro Seta” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin e përcaktuar në nenin 16, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”; si dhe nenin 16, pika 7.

- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores dhe ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

- Në këtë aplikim konstatohet mungesa e dokumentacionit/informacionit sipas nenit 16, germa “c”, informacionin/deklarimin përkatës për ushtrimin e veprimtarisë.

- Për dokumentacionin e munguar do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 433, seria T19, të shoqërisë “Hydro Seta” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime

materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 235, datë 19.7.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 243, DATË 2.12.2021, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.7.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1803/2 prot., datë 14.7.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 243, datë 2.12.2021, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Noa Energy Trade’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 243, datë 2.12.2021, vendosi të licencojë shoqërinë “Noa Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke i lënë kusht shoqërisë që me fillimin e operimit, të depozitojë në ERE sistemin IT.

- ERE, me shkresën nr. 1803 prot., datë 16.6.2023, i kërkoi shoqërisë informacion për sa lënë kusht në pikën 2 të vendimit nr. 243/2021.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1803/1 prot., datë 30.6.2023, shoqëria depozitoi kontratën për ofrimin e shërbimeve IT, të lidhur më datë 4.1.2023, me një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), afat



i cili e mbulon gjithë periudhën e licencimit të shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k.

- Për sa më sipër, rezulton se shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 243/2021.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet e drejta e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 243, datë 2.12.2021, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Noa Energy Trade’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Noa Energy Trade” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 355, datë 1.12.2023

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika

1, germa “e”, 5, pika 1, germa “e” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2416/1 prot., datë 24.11.2023 të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqizë’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2416 prot., datë 17.11.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a”, “c” dhe “d”.

- Nga ky aplikim rezulton se nevojitet të plotësohet dokumentacioni/informacion në vijim:

Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”

- Germa “b”: Të depozitohet vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti) e lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për administratorin e saj.

- Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”

- Germa “a”: Të raportohet mbi vlerën e debisë së pashlyer ndaj Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Dibër, si dhe shlyerjen e kështit të fundit që i përket datës 20.12.2023, sipas planit të pagesave të “Marrëveshje për pagesën me këste të detyrimeve tatimore”, me nr. 1943/1 prot., datë 30.6.2022, nënshkruar midis Drejtorisë Rajonale Tatimore



Dibër dhe shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., duke mbajtur në konsideratë se duhet të depozitohet në ERE vërtetimi që nuk ka detyrime të pashlyera, si ndaj organeve tatimore, ashtu edhe ndaj atyre të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- Germa “b”: Të depozitohet dokumentacion mbi mbështetjen financiare, e cila duhet të garantojë të paktën 1 (një) muaj të ushtrimit të aktivitetit, referuar sasisë së parashikuar nga vetë aplikuesi.

- Germa “c”: Të depozitohet në ERE plani i biznesit i dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Pika 2.5, “Dokumentacioni specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike”

- Shoqëria duhet të saktësojë të dhënat në lidhje me sasinë e energjisë elektrike (në gwh) që parashikon të tregtojë gjatë 5 (pesë) vjetëve të ardhshëm të licencës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 356, datë 1.12.2023

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 126, DATË 31.5.2022, “MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ‘ENERGY FINANCING TEAM TIRANA’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2196/2 prot., datë 22.11.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 126, datë 31.5.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Energy Financing Team Tirana’ sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, ndër të tjera, me vendimin nr. 126, datë 31.5.2022, ka vendosur që shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. të përcjellë në ERE informacion çdo tre muaj, në lidhje me ecurinë e procesit gjyqësor, deri në dokumentimin e një vërtetimi të pastër tatimor.

Po ashtu, shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit, dokumente që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’u ofrohen klientëve.

- ERE, me shkresën nr. 2195/2 prot., e njoftoi shoqërinë për seancë dëgjimore në datën 6.11.2023, ora 11:00. Në seancën e zhvilluar me përfaqësuesit e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k., ndër të tjera, i kujtoi shoqërisë kushtet e lëna në vendimin nr. 126/2022.

- Shoqëria në seancën dëgjimore të datës 6.11.2023, të zhvilluar me përfaqësuesit e shoqërisë “Energy Financing Team Tirana”



sh.p.k., informoi se në lidhje me kushtin e lënë në pikën 2 të vendimit të Bordit të ERE-s, procesi gjyqësor në shkallë të parë ka përfunduar dhe shoqëria e ka fituar atë, por Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e ka apeluar dhe duke qenë se procedurat gjyqësore zgjasin, nuk kanë informuar, pasi nuk kanë një vendim të gjykatës të formës së prerë.

- Në vijim me shkresën e protokolluar në ERE nr. 2195/1 prot., datë 8.11.2023, shoqëria depozitoi dokumentacionin përkatës për sa informuar në seancën dëgjimore.

- Për sa sqarohet dhe depozitohet nga shoqëria në lidhje me plotësimin e kushtit të lënë në pikën 2, duke qenë se është ende në proces gjyqësor vlerësohet se shoqëria, të depozitojë në ERE menjëherë nga marrja dijani e një vendimi të formës së prerë, vërtetimin e pastër tatimor ose vendimin e Gjykatës së Apelit.

- Në lidhje me kushtin e lënë në pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s, ku shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. duhet të përcjellë në ERE brenda 30 ditëve nga marrja dijani e vendimit, dokumente që vërtetojnë aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2195/1 prot., datë 8.11.2022, ka depozituar kontratat e qirasë me nr. 925 rep., nr. 691 kol., datë 27.10.2017 dhe nr. 961 rep., nr. 713 kol., datë 10.11.2017, ku në nenin 3 të këtyre kontratave është përcaktuar se: kontrata lidhet për një afat të papërcaktuar dhe ka hyrë në fuqi më datë 1 tetor 2017. Evidentohet se këto kontrata mbajnë datë të hershme, por rezulton se shoqëria nuk i ka depozituar përgjatë procedurës së rinovimit për sa kërkohet nga ERE, në kuadër të plotësimit të kushteve.

- Me depozitimin e këtij informacioni, rezulton se shoqëria aktualisht disponon kontratat e kërkuara në pikën 3, të vendimit të Bordit nr. 126/2022, ndaj vlerësohet që kjo pikë të shfuqizohet.

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 126/2022 ndryshon dhe bëhet:

2. Shoqëria “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. të depozitojë në ERE, menjëherë nga marrja dijani të një vendimi të formës së prerë, vërtetimin e pastër tatimor ose vendimin e Gjykatës së Apelit.

2. Pika 3 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 126/2022 shfuqizohet.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Energy Financing Team Tirana” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 358, datë 1.12.2023

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE- s, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E SHOQËRISË “SWISS BALANCING POOL” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-



s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2302/9 prot., datë 24.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2302 prot., datë 17.10.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 311, datë 30.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.11.2023 dhe 2.11.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 9.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 2302/5 prot., datë 1.11.2023, ERE iu drejtua shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin/saktësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar apo plotësuar pjesërisht. Kjo shkresë u kthye nga shërbimi postar, me shënimin “I panjohur”, ndaj në vijim, ERE njoftoi shoqërinë nëpërmjet adresës së *e-mail*-it nga vetë shoqëria, dërguar nga ERE më datë 7.11.2023.

- Në mbledhjen e planifikuar të Bordit të ERE-s nr. 61 datë 1.12.2023, shoqëria me shkresën me nr. 2302/7 prot., datë 23.11.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues për aplikimin e saj, pasi është njohur me vendimin nr. 311/2023 në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Ky dokumentacion u dorëzua përpara shqyrtimit të relacionit me nr. 2302/3 prot., datë 24.11.2023, nga Bordi i ERE-s.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga shoqëria, në kuadër të plotësimit të dosjes së aplikimit dhe nevojës që mund të lindë për ndonjë korrespondencë të mundshme pas shqyrtimit të dokumenteve, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool”

sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 359, datë 1.12.2023

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-
s, NË LIDHJE ME APLIKIMIN E
SHOQËRISË “SWISS BALANCING
POOL” SHPK, PËR LICENCIM NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e



ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 1.12.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2303/4 prot., datë 24.11.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së bordit të ERE-s, në lidhje me aplikimin e shoqërisë ‘Swiss Balancing Pool’ sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2303 prot., datë 17.10.2023, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 310, datë 30.10.2023, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 1.11.2023 dhe 2.11.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 9.11.2023), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën me nr. 2302/5 prot., datë 1.11.2023, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin/saktësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar apo të plotësuar pjesërisht. Kjo shkresë u kthye nga shërbimi postar, me shënimin “I panjohur”, ndaj në vijim, ERE njoftoi shoqërinë nëpërmjet adresës së *email*-it dhënë nga shoqëria, në datë 7.11.2023.

- Në mbledhjen e planifikuar të Bordit të ERE-s nr. 61, datë 1.12.2023, shoqëria me shkresën me nr. 2302/7 prot., datë 23.11.2023, ka depozituar dokumentacion plotësues për aplikimin e saj, pasi është njohur me vendimin nr. 310/2023 në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Ky dokumentacion u dorëzua përpara shqyrtimit të relacionit nr. 2303/4 prot., datë 24.11.2023, nga Bordi i ERE-s.

- Për shkak të kohës së pamjaftueshme për të shqyrtuar dokumentacionin e depozituar nga

shoqëria, në kuadër të plotësimit të dosjes së aplikimit dhe nevojës që mund të lindë për ndonjë korrespondencë pas shqyrtimit të dokumentacionit, vlerësojmë të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit mbi aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., për t’u licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, parashikohet se Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë, kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin për marrjen e vendimit përfundimtar për aplikimin e shoqërisë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Swiss Balancing Pool” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Shtetasi Sotiraq Vidhaj, kërkon pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë shpalljen të zhdukur të shtetasit Vasillaq Vidhaj që prej datës 22.3.1997.

KËRKUES
Sotiraq Vidhaj

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 240 lekë